

**Mospajtime**  
BESA me  
dy Kongrese  
zgjedhore?

Fq.3



**NISMA  
KOMBËTARE**  
"Viti i  
Skënderbeut"  
edhe në Maqedoni

Fq.4



**Klubi më  
i vështirë  
dhe më i  
kërkuari  
në botë**

Fq.22



# Koha

www.koha.mk



**Një shtet  
brenda  
shtetit!**

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3264 · e enjte 11 janar, 2018

+3°C | +8°C

15 DEN

## EDITORIAL

**Pse te shqip-  
tarët mospaj-  
timet quhen  
përçarje?**



Përtacia për ti zbrërthyer thënie-  
t që prodhojnë dubioza, zakoni-  
sht, na ka lënë të akomodojmë  
oportunitetin tonë në vagonët e  
fundit të mendësisë partizane.  
Pra, as Lëvizja Besa nuk mund të  
bëjë përjashtim nga ky itinerar  
trenash të çmendur, mirëpo  
është luks i tepër i yni të shumë-  
zojmë budallallëkun tonë me ve-  
primet...

Fq.2

## RAJON

**Largimi i  
trurit, shkak  
ekonomia  
dhe siguria  
publike**

Fq.14

## GLOBI

**Fëmijët e  
ISIS-it, ata  
që nuk patën  
mundësi të  
zgjedhin**

Fq.15



## RRITJA E ÇMIMEVE TË KARBURANTEVE NË MAQEDONI

# "HARAÇ" APO ZHVILLIM?



**Çmimi i benzinës në Maqedoni është 1.081 euro për një litër që është më shtrenjtë se në Poloni ku paguhet 1.067 euro për 1 litër, ndërsa i afrohet me çmim edhe Luksemburgut ku vozitësit paguajnë 1.180 euro për një litër**

Fq.7

## Tetova vuan për tetë autobusë

Tetovë, 10 janar - Tetova ndoshta në të kaluarën kishte një kompani auto-transportuese që organizonte transport publik dhe jo vetëm brenda territorit të Komunës së Tetovës, por edhe komunat rurale. Tashmë dhjetë vite e këndej, kompania "Polet" nuk funksionon dhe praktikisht, tetovarët nga një skaj në skajin tjetër për të kryer ndonjë punë duhet që të përdorin automjetet. Qytetarët theksojnë se transporti pu-

blik do të zgjidhte shumë probleme. "Nuk është normale që një qytet të mos ketë transport urban, sepse qytetarët nuk do të merrnin automjetet, por do të shfrytëzonin transportin, kjo në radhë të parë do të kishte edhe më pak harxhime për vet qytetarët që është aspekti ekonomik, por edhe do të vinte rregull në komunikacion", thotë Blerim Jashari, qytetarë i Tetovës. Në ndërkohë, nga...


Fq.6



## EDITORIAL

# PSE TE SHQIPTARËT MOSPAJTIMET QUHEN PËRÇARJE?

Përtacia për ti zbrëthyer thëniet që prodhojnë dubioza, zakonisht, na ka lënë të akomodojmë oportunitetin tonë në vagonët e fundit të mendësisë partizane. Pra, as Lëvizja Besa nuk mund të bëjë përjashtim nga ky itinerar trenash...



Emin AZEMI

Të mos pajtohesh më dikë, është normale. Mirëpo, të ngutësh që mospajtimin ta paketosh si mosdurim, mllëf, neveri, jo vetëm që nuk është normale, por i bie që ne në fakt më të gatshëm jemi të grindemi se sa të debatojmë esëll, më të zellshëm të punojmë jashtë procedurave se sa të sillemi brenda rregullave demokratike. Paaftësia për të punuar brenda këtyre rregullave, herët a vonë, nxjerr nga përdorimi arsyen dhe në vend të saj instalon anarkinë, si mjeti më i lirë i zhonglerëve që shiten si "gardian të parimeve".

Edhe ndodhitë e fundit në Lëvizjen Besa, si duket e kanë këtë gjenezë problemesh. Pra, ata që nuk pajtohen me Bilall Kasamin, që edhe më tej të jetë në krye të kësaj Lëvizjeje, e kanë zgjedhur rrugën më të lehtë e më të shkurtër, por më pak të lavdishme, për të arritur te pika ku shumëfishohen të gjitha viruset përçarjes. Nëse ardhja e tij si lider i këtij grupimi politik ka qenë brenda frymës statutare dhe një konsensusi më të gjerë, pse kjo nuk po mundka të zbatohet edhe tani kur në adresë të tij ka pakënaqësi të caktuara dhe kërkesa për ta zëvendësuar me një tjetër. Madje, lista e pakënaqësive mund të jetë edhe shumë më e gjatë se ajo që është afishuar në publik, mirëpo shkarkimit dhe "kthimit" të tij me ndihmën e "bodiguardëve", i japin shijë të hidhur, pikërisht, metodat "kauboje" e joparimore, kundër të cilave kanë qenë gjithmonë eksponentët dhe frontmenët e kësaj partie. Këta të fundit ka të ngjarë që para se të kenë rënë viktimë e një ambicijeje të pakuptimë për pushtet "brenda llojit", në fakt kanë interpretuar mbrapsht kodin e sjelljes politike, e cila i kishte bërë deri dikund të ndryshëm nga të tjerët.

Dikush mund të thotë se përçarja na qenka sindrom shqiptar, por asnjëherë nuk u sollën argumente të mjaftueshme që ta marrim si të mirëqenë këtë thënie "lapidare". Dhe, përtacia për ti zbrëthyer thëniet që prodhojnë dubioza, zakonisht, na ka lënë të akomodojmë oportunitetin tonë në vagonat e fundit të mendësisë partizane.

Pra, as Lëvizja Besa nuk mund të bëjë përjashtim nga ky itinerar trenash të çmendur, mirëpo është luks i tepërti yni të shumëzohim bu-dallallëkun tonë me veprimet e ngutshme e të pamatura mirë të një tufe njerëzish që duan të bëhen lider pa respektuar procedurat dhe normat demokratike.

Fundja, kujt i hy në punë ai politikan që mundohet të katapultohet përmes metodave që do t'ia kishte lakmi çdo karrocier i dehur?

## HESHTJA NË LOKAL

"Pse nuk flasim asgjë shkrimtarët për këtë tollovi?, pyeti banakieri të riun që shërbente në lokalin ku zakonisht rinin njerëzit e letrave. Banakieri ishte i hutuar pasi ishte mësuar që klientët të ishin të zëshëm duke komentuar çdo kacafytje që ndodhte përballë lokalit. Heshtja detyroi të riun të jetë i kujdesshëm që klientët të mos dëgjojnë përgjigjen që kishte. Duke iu afruar afër veshit, i pëshpëriti banakierit: 'Tani tollovia ndodh afër pusit të tyre. Heshtin pasi kanë frikë se mos u turbullohet uji. Nuk përballojnë dot etjen këto'. Do të thotë se presin të qartësohet se kush do të ketë nën kontroll pusin, tha banakieri dhe iu kthye punës", shkruan në profilin e tij në Facebook, analisti Xhelal Neziri.



## KUR HUMB DHE DORËHIQESH

"Ljubço Georgievski dha dorëheqje kur i humbi zgjedhjet e vitit 2002. Vllado Buçkovski dha dorëheqje kur i humbi zgjedhjet e vitit 2006. Branko Cërvenkovski dha dorëheqje kur i humbi zgjedhjet e vitit 2013. Nikola Gruevski dha dorëheqje pas humbjes në zgjedhjet lokale 2017. Nga ana tjetër, Menduh Thaçi ka humbë në çdo zgjedhje që ka garuar dhe nuk jep dorëheqje. Bilall Kasami humbi në zgjedhjet e 2016 nga BDI, dhe në zgjedhjet e 2017 për kryetar Tetovë dhe nuk jep dorëheqje. Zijadin Sela humbi në zgjedhjet e 2016 nga BDI dhe në 2017 për kryetar të Strugës dhe nuk jep dorëheqje. Kush e kupton, merr vesh!", shkruan në Facebook, dr.Armend Nuhiu.



## NJË PROPOZIM PËR PAJTIM

"Qeveria e Kosovës duhet ta hartojë Projektligjin për amnistinë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës të cilët më 2015-2017, në një gjendje jo të rëndomtë dhe me mjete jo të rëndomta, brenda objektit të Kuvendit të Kosovës mbrojtën rendin kushtetues të Kosovës prej dëmit që ka mundur të shkaktojë Marrëveshja për Asociacionin e Komunave Serbe. Me këtë ligj pezullohen vendimet gjyqësore të tanishme apo hapja e procedurave legale të ardhshme ndaj deputetëve të Kuvendit të Kosovës që përdorën mjete jashtë normave parlamentare për të mbrojtur Kushtetutën e vendit. Projektligji duhet të marrë përkrahjen eksplicite të Grupeve parlamentare, përfaqësuesit e të cilave në një ceremoni të përbashkët do të nënshkruanin dokumentin e përkrahjes. Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e vet të parë, me procedurë të shpejtuar, duhet të shqyrtojë dhe miratojë Ligjin për amnisti. Me këto tri hapa, partitë politike të Kosovës do të manifestonin, mes tjerash, nevojën për tejkalim të polarizimeve të së kaluarës, nevojën për unitet dhe gatishmërinë për solidaritet pa marrë parasysh kush është në pushtet a opozitë. Me këtë, po ashtu, partitë do të zotoheshin që në të ardhmen, për çështje jetike të vendit, do të marrin vendime vetëm në bazë konsensusi", shkruan në FB, publicisti Veton Surroi.



## ZHAGITJA DHE ZGJEDHJET E PARAKOHSHME

"Bojkoti, zhagitja, negociatat e pafundme janë një dëshmi se ky shtet do të duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Maqedonia. Po edhe Kosova gjithashtu. Për Shqipërinë presim të shohim Lulin çka do të bëjë, nëse bën ndonjë gjë", shkruan në Facebook aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



## MEDIA Citate

Rreth 100 emigrantë janë zhdukur pas përmbyesjes së një varke në brigjet e Libisë, ndërsa rreth 280 janë shpëtuar, njoftoi sot marina e këtij shteti të Afrikës veriore. Theksohet se emigrantët, shumica nga Afrika, u nisën në rrugën e rrezikshme përmes Detit Mesdhe në disa mjete lundrimi. Të gjithë të zhdukurit gjendeshin në gomone e cila u përmbyes gjatë lundrimit. Marina thekson se të mbijetuarit, të cilët janë gjetur të martën, janë transferuar në bazën detare në kryeqytetin Tripoli. Bregu perëndimor libian këtë vit është rruga përmes së cilës emigrantët afrikanë tentojnë të arrijnë në vendet evropiane.  
(Anadolu Agency, 10 janar)

Pothuajse 20 vjet pas të ashtuquajturës Marrëveshja e Paqes së të Premtes së Mirë, politika e Irlandës së Veriut vazhdon ende të dominohet nga nacionalistët në njërën anë dhe nga unionistët nga ana tjetër. Nacionalistët e ndjejnë tradicionalisht veten si qytetarë irlandezë dhe janë pro ribashkimit me Irlandën, ndërsa unionistët e konsiderojnë veten si qytetarë britanikë dhe duan të vazhdojnë të jenë pjesë e Britanisë së Madhe. Por dy palët armiqësore gjatë konfliktit e qeverisën vendin në koalicion për pothuajse nëntë vjet. Deri një vit më parë, kur shkaku për krizën qeveritare u bë një program për nxitjen e energjive të rinovueshme.  
(DW, 10 janar)

Përderisa Kosova po bëhet gati që muajin e ardhshëm të shënojë 10 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së vendit, në anën tjetër Serbia ka paralajmëruar ofensivë diplomatike, jo vetëm për të bllokuar njohjet e reja të shtetit të Kosovës, por edhe për të siguruar tërheqjen e disa prej këtyre njohjeve. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës dhe njohësit e të drejtës ndërkombëtare vlerësojnë se ofensiva e diplomacisë serbe kundër shtetit të Kosovës dhe njohjeve të saj është zhvilluar në vazhdimësi, që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, por se ajo tashmë është bërë më e dukshme dhe më e diskutueshme në media.  
(REL, 10 janar)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## ÇFARË DIHET PËR BETEJËN E CARRALEVËS?

Beteja e Carralevës (1910) ishte betejë ndërmjet kryengritësve shqiptarë të udhëhequr nga Isa Boletini dhe forcave të ushtrive osmane të komanduara nga gjenerali Shefqet Turgut Pasha. U zhvillua në rajonin Shtimje-Jezercë-Carralevë (Kosovë). Morën pjesë 20.000 ushtarë turq, kundër 8.000 shqiptarëve. Më 8 maj njësitë turke u hodhën në mësymje masive, por ndeshën në qëndrueshmëri të vendosur të shqiptarëve. Sulmet e

përsëritura më 9-10 maj mundën të çajnë sektorin e mbrojtjes së kryengritësve në Jezercë. Më 11 maj forcat osmane, si dhe dy grupe të tjera të ndihmuara nga disa batalione të reja, të ardhura nga Prizreni e Mitrovica, rrethuan grupin e Isa Boletinit. Në orët e pasdites kryengritësit çanë rrethimin dhe u tërhoqën drejt Drenicës. Nga të dy palët pati shumë të vrarë e të plagosur.



GRUPI I NEXHEMEDIN KAHREMANIT DO TI DREJTOHET GJYKATËS

# BESA ME DY KONGRESE ZGJEDHORE?

Të dyja grupet - ai i Bilall Kasamit dhe ai i Nexhmedin Kahremanit pretendojnë se kanë të drejtë në veprimet e tyre, duke lajmëruar mbajtjen e Kongresit Zgjedhor. Nga qëndrimet e të dyja palëve shihet se pak gjasa ka për pajtim dhe se duket që do të kemi dy kongrese paralele

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 10 janar - Në lëvizjen BESA vazhdon lufta për pushtet partiak. Të dyja grupet - ai i Bilall Kasamit dhe ai i Nexhmedin Kahremanit pretendojnë se kanë të drejtë në veprimet e tyre, duke lajmëruar mbajtjen e Kongresit zgjedhor. Nga qëndrimet e të dyja palëve shihet se ka pak gjasa për pajtim dhe me gjasë, duket që do të ketë dy kongrese paralele. Megjithatë, do të ketë rëndësi se si do të vendosë Gjykata meqë grupi i Nexhmedin Kahremanit njoftojnë se shumë shpejtë do të ndjekin procedurat gjyqësore me pretendimin se kanë shumicën në Këshillin Qendror. Se kanë shumicën në Këshillin Qendror pretendojë edhe nga grupi i Bilall Kasamit dhe sipas asaj që thonë nga ky grup, mezi presin se çfarë do të vendosë Gjykata, duke qenë të sigurt se legjitimiteti qëndron në anën e tyre. Orhan Murtezani, ish-zëdhënës i partisë dhe pjesëmarrës në mbledhje kur u shkarkua Bilall Kasami, në një prononcim për gazetën KOHA thotë se shumë shpejtë do të fillojnë me procedurat gjyqësore për të vërtetuar, siç thotë ai, zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për ushtrues detyre i kryetarit të përkohshëm të kësaj partie deri në Kongres. "Këto ditë do të fillojmë me zgjedhjet e brendshme në parti deri në mbajtjen e Kongresit të parë zgjedhor. Paraprakisht do të dërgojmë deri në gjykatë vendimet e fundit të Këshillit qendror për zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për koordinatortë përkohshëm të Lëvizjes BESA deri në Kongres, si dhe vendimin për shkarkimin e Bilall Kasamit", thotë Murtezani. Nëse ka hapësirë dhe nëse po punohet për pajtim të dy grupeve, Murtezani thotë se pajtimi do të vinte në shprehje nëse Kasami reflekton mbi vendimin e Këshillit që e ka shkarkuar. Sipas tij, jo vetëm Kasami, por askujt nga BESA që ka ide dhe program - nuk i mohohet



kandidatura për kryetar.

"Ai organ, pra Këshill që e ka zgjedhor para tre viteve, po i njëjti e ka shkarkuar Bilall Kasamin me shumicë votash. Këtë nuk kemi për çfarë ta diskutojmë kur vendos shumica në parti. Tjetër do të ishte nëse Bilall Kasami reflekton mbi vendimet e organit të lartë partiak dhe të pranojë shkarkimin, atëherë pse jo - do të hapej mundësia për pajtim. Sa i përket kandidatëve për kryetar, askujt në Lëvizjen BESA e as Bilall Kasamit nuk i mohohet kandidimi, por së pari duhet të respektohen vendimet e shumicës së anëtarëve të Këshillit", thekson Murtezani. Nga ana tjetër, zyrtarë të lartë nga Lëvizja BESA në grupin e Bilall Kasamit thonë se e vetmja mbledhje legjitime e Këshillit qendror është ajo e mbajtur më 6 janar në Tetovë. "Çdo mbledhje tjetër e Këshillit Qendror përveç asaj që është mbajtur në Tetovë më 6 janar, është jolegjitime. Në atë mbledhje u vendos që Bilall Kasami të mbetet kryetar deri në Kongres, më pastaj do të vendos Kongresi me shumicën e anëtarëve për kryetarin e ri", tha njëri nga zyrtarët e Lëvizjes BESA. Siç thotë ky zyrtar, që insistoi në anonimitet, Komisioni për organizimin e Kongresit ka filluar punë, ndërsa sipas tij, individët që nuk do vijin në Kongres - do të llogariten si të vetpërgjatur. Por në fund, sipas tij, se kush ka të drejtë - atë do ta thotë Gjykata. "Ata që kanë mbajtur mbledhje tjetër janë individë që kanë thyer rregullat partiake. Komisioni për organizimin e Kongresit është zgjedhur dhe ka filluar

preparimet për strukturat partiake për zgjedhjen delegatëve për Kongres. Ata individë që nuk do të vijin në Kongres, ata dhe vetpërgjatur - askush askënd s'do ta përjashtojë deri në Kongres. Se kush ka të drejtë, do ta thotë Gjykata. Edhe vetë Nexhmedin Kahremani e tha sot se do të vendosë Gjykata, pra le të vendosë Gjykata dhe të shohim se kush ka të drejtë", thonë zyrtarë të lartë të Lëvizjes BESA nga grupi i Bilall Kasamit. Në lidhje me grupin parlamentar se si do të funksionojë më tutje, Orhan Murtezani thotë se tre nga pesë deputetët e pranojnë shkarkimin e Kasamit dhe zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për ushtrues detyre të kryetarit. Sipas tij, grupi parlamentar edhe më tutje do të funksionojë i plotë si grup i Lëvizjes BESA. "Grupi parlamentar nuk mund të jetë i përçarë, sepse dikush nga grupi duhet të deklarohet se nuk është BESA që të prishet grupi. Por, e vërteta është se për deputetët e BESËS - Afrim Gashi, Rexhep Memedi dhe Nexhmedin Kahremani, Bilall Kasami është i shkarkuar nga detyra e kryetarit dhe u.d.kryetar është Nexhmedin Kahremani. Grupi parlamentar edhe më tutje do të jetë i plotë si grup i Lëvizjes BESA", shprehet Murtezani. Në lidhje me grupin parlamentar, edhe deputeti Fadil Zendeli thotë se pavarësisht ndodhive në parti, në Parlament do të funksionojë i plotë. Ai paralajmëroi se lidhur me këtë çështje do të dalin me deklaratë të përbashkët për media.

"Pavarësisht ndodhive në parti,

kjo nuk do të ndikojë në përçarjen e grupit parlamentar. Ne do të funksionojmë si grup parlamentar i Lëvizjes BESA edhe më tej. Ndoshta do të dalim edhe me deklaratë të përbashkët për media lidhur me këtë çështje", theksoi për gazetën KOHA deputeti Fadil Zendeli. Ndryshe, ish-zëdhënës i partiak, Orhan Murtezani, ishte ai që më 5 janar - në praninë e shumë anëtarëve të kryesisë së Lëvizjes BESA në një Konferencë për shtyp kumtoi shkarkimin e Bilall Kasamit dhe zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për ushtrues detyre të kryetarit të Lëvizjes BESA deri në mbajtjen e Kongresit zgjedhor më 24 shkurt të këtij viti. Sa i përket anës juridike, organet e Lëvizjes BESA janë të përkohshme dhe ende kjo parti nuk ka mbajtur Kongres zgjedhor dhe nuk ka kryetar me mandat të rregullt politik. Edhe vetë funksionarët nga të dyja kampet e pranojnë në biseda joformale se Bilall Kasami është zgjedhur koordinatortë përkohshëm - pra juridikisht quhet edhe Nexhmedin Kahremani koordinatortë përkohshëm, por që luan rolin e kryetarit të partisë deri në zgjedhjen e organeve të rregullta. Nëse i referohemi Statutit të Lëvizjes BESA, kryetarin e partisë e zgjedh dhe e shkarkon Kongresi i partisë. Në nenin 39, pika 9 thuhet: "vendos për shkarkimin e Kryetarit të Lëvizjes mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga 2/3 e anëtarëve të Kongresit". Por, meqë në mungesë të Kongresit organi më i lartë është Këshilli në këtë rast i përkohshëm, sipas anëtarëve të

grupit të Nexhmedin Kahremanit, Këshilli është siç e ka zgjedhur Bilall Kasamin ashtu dhe e ka shkarkuar. Ata thirren në nenin 14 për përjashtimin e anëtarëve të partisë kur thejnë rregullat dhe nuk i përfillin vendimet e organeve partiake. Në këtë rast, sipas grupit të Kahremanit, Kasami nuk ka thirrur mbledhje të Këshillit edhe pas kërkesë së shumicës së anëtarëve të këtij organi.

Në këtë drejtim ka folur edhe anëtari i Kryesisë qendrore, Skënder Rexhepi-Zejd. "Ne jo vetëm nga 1/3, por kemi mbledhur nënshkrime nga 58 anëtarë që i bie të jetë shumica e anëtarëve të Këshillit qendror dhe ai (kryetari) përsëri e ka anashkaluar këtë vendim dhe nuk e ka thirrur mbledhjen, dhe me automatizëm ne nuk kemi bërë asnjë shkelje. Çdo ftesë për nënshkrim që ua kemi dhënë anëtarëve ka qenë me të drejtën e tyre të nënshkruajnë dhe ta lexojnë letrën se për çfarë po nënshkruajnë. Ne kemi thirrur mbledhjen dhe në atë mbledhje kanë ardhur mbi 60 anëtarë të Këshillit qendror, që do të thotë se shumica e anëtarëve kanë qenë prezent", ka deklaruar Skënder Rexhepi-Zejd. Ndërkaq nga grupi i Kasamit thonë se Këshilli Qendror nuk ka të drejtë të shkarkojë kryetarin e partisë qoftë edhe me mandat të përkohshëm. Njëjtë si Bilall Kasami, ashtu edhe Nexhmedin Kahremani është zgjedhur nga Këshilli Qendror si organi më i lartë partiak pas Kongresit, meqë Kongres zgjedhor nuk ka pasur që kur u themelua kjo parti para tre viteve. Mbetet të shihet se si do të vendosë Gjykata nëse nuk ka pajtim nga dy grupet dhe nëse do të ketë dy Kongrese paralele zgjedhore. Sa i përket gjendjes faktike, juristët thonë se ka rëndësi si do të veprojnë shumica e strukturave, sidomos Këshilli qendror dhe Kryesia qendrore që kanë përgjegjësi për organizimin e Kongresit, pra nga cili grupi do të shkojnë në Kongres. Shumë figura tjera të Lëvizjes BESA ende rrinë neutral si kryetari i Komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu apo anëtari i kryesisë, Amir Elezi, që ishte kandidat për Komunën e Tearcës në zgjedhjet lokale. Megjithatë, ka zëra se do të ketë pajtim të të dyja grupeve ditëve në vijim. Sipas burimeve tjera partiake, të dyja grupet nëse nuk bëjnë asgjë për pajtim - do të dëmtojnë partinë në besimin e qytetarëve. Edhe Bilall Kasami i ftuar në TV21 mbrëmjen e së martës bëri thirrje për bashkim duke insistuar vazhdimisht se Lëvizja BESA nuk do të përçahet. Po atë ditë, ai kishte një takim me kryeministrin Zoran Zaev me fokus mbështetjen e Qeverisë në agjendën e saj për reformë, por që nuk e përjashtoi mundësinë për hyrjen e BESËS në Qeveri.

## AS BESA E AS PDSH NUK DO JENË PJESË E QEVERISË

As PDSH dhe as Lëvizja BESA nuk do të jenë pjesë e Qeverisë ndërsa se cila parti do të jetë pjesë e qeverisë aktuale për momentin nuk dihet. Kështu përgjigj zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, në pyetjen e gazetarëve se kryeministri Zoran Zaev ia ka hapur dyert Lëvizjes BESA të jetë partner i ri i koalicionit qeveritar pas largimit të Aleancës për Shqiptarët nga Qeveria. "Takimi i djeshëm i realizuar midis kryeministrit Zoran Zaev dhe e kryetarit të Lëvizjes BESA ka qenë i paralajmëruar shumë me herët, e jo pas ngjarjeve të fundit që ndodhën në

këtë parti. Në këtë takim është biseduar për përkrahjen e Lëvizjes BESA në miratimin e disa ligjeve që tani janë në procedurë parlamentare dhe aspak nuk është biseduar për hyrjen e Lëvizjes BESA në Qeveri. Edhe në takimet e realizuara me PDSH-në midis kryeministrit dhe kryetarit të kësaj partie nuk është biseduar se kjo parti mund të jetë pjesë e Qeverisë aktuale. Për momentin Parlamenti ka shumicën parlamentare që të mund të miratohen të gjitha ligjet që janë në procedurë parlamentare për votim", tha Boshnjakovski. (Z.V)

Viti 2018 do të jetë viti kushtuar heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, përkatësisht 550 vjetorit të vdekjes dhe do të shënohet nga një sërë aktivitete, ku si bartës është Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore, si edhe Parlamenti. Për këtë qëllim është formuar një këshill organizativ i drejtuar nga Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, Skënder Hasani, si edhe anëtarë, studiues nga fusha të ndryshme



## "VITI I SKËNDERBEUT" EDHE NË MAQEDONI

Koha

Evis HALILI

Shkup, 10 janar - Nismës mbarëshqiptare "Viti i Skënderbeut" me vonesë i është bashkuar edhe Maqedonia. Viti 2018 do të jetë viti kushtuar heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, përkatësisht 550 vjetorit të vdekjes dhe do të shënohet nga një sërë aktivitete, ku si bartës është Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore, si edhe Parlamenti. Për këtë qëllim është formuar një Këshill organizativ i drejtuar nga kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, Skënder Asani, si edhe anëtarë, studiues nga fusha të ndryshme.

Në fund të kësaj jave do të bëhet publike agjenda e aktiviteteve që do të shënojnë këtë vit. Manifestimi i parë është më datë 17 janar, kur mbushen edhe 550 vjet nga vdekja e heroit kombëtar. Në Shkup do të organizohet një Akademi

përkujtimore dhe do të promovohet pulla postale me imazhin e heroit kombëtar, promovim ky që do të pasohet edhe me një ceremoni tjetër përkujtimore në Prishtinë ku do të jetë prezent edhe kreu i Parlamentit, Xhaferi.

Data 17 janar është pjesë e kalendarit të shënimeve jubilarë, të miratuara nga Parlamenti muajin e kaluar. "Me formimin e Këshillit organizativ ku bëjnë pjesë personalitete nga sfera të ndryshme ne synojmë që të shënojmë një vit me aktivitete që do t'i kushtohen figurës dhe veprës së heroit tonë, por njëkohësisht t'i bashkohemi edhe ne nismës mbarëkombëtare të qeverisë së Shqipërisë për të shënuar këtë vit. ITSHKSH do të jetë bartës, por po ashtu në bashkëpunim me

Parlamentin, si edhe me institucione të tjera ne parashikojmë të realizojmë një program aktivitete. Takim i parë i Këshillit organizativ do të jetë të premten, kur edhe do të prezantohet listën e aktiviteteve", thotë zëvendëskryetari i Këshillit Organizativ për shënimin e Vitit të Skënderbeut, Skënder Asani.

Një prej vendimeve të para të Qeverisë së Shqipërisë, pas formimit në muajin gusht të vitit të kaluar ishte shpallja e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut - 28 nëntor 2017 - 28 nëntor 2018. Datat madhore të Vitit të Gjergj Kastrioti Skënderbeut - 574 vjetori i Pavarësisë (Hyryes së Skënderbeut në Krujë), 17 janar - 550 vjetori i vdekjes së Skënderbeut, 10 qershor - 140 vjetori i Lidhjes së Prizrenit, si edhe 14-22

nëntor - 110 vjetori i Kongresit të Manastirit.

Në shënime të Vitit të Skënderbeut, në Maqedoni do të jenë këto katër data si kryesore, por në harkun kohor të këtij viti do të përfshihen po ashtu edhe shënime për data dhe personalitete me rëndësi për historinë dhe kulturën kombëtare. Gjithashtu, edhe 110 vjetori i Kongresit të Manastirit planifikohet që të organizohet si një datë e veçantë. Punimet për rikonstruktimin e këtij objekti ende nuk kanë nisur, për shkak të vonësve në nënshkrimin e marrëveshjes. Por sipas drejtuesve të këtij institucioni punimet janë parashikuar që gjithsesi të përfundojnë në kohë, në mënyrë që Muzeu i Shtëpisë së Alfabetit të jetë gati për të shënuar përvjetorin.

### OSMANI PËR TV "ANTENA"

## Mendoj se po i vjen fundi kontestit me emrin

Athina, 10 janar - Ekziston një zgjidhje e pranueshme për të dyja palët, mendoj se kemi arritur deri tek fundi i problemit, thotë zëvendëskryeministri për Eurointegrime, Bujar Osmani në intervistën për televizionin grek TV Antena. Shkurt pas takimeve të djeshme me homologët e tij, Nikos Koxias dhe Jorgos Katrugalos, njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Osmani duke folur për televizionin sqaron se problemi me emrin përveç se e bllokoi perspektivën euroatlantike të Maqedonisë, paraqet edhe pengesë për bashkëpunimin bilateral. "Mendoj se po i vjen fundi këtij kontesti. Ne na mori 25 vjet mundësi për bashkëpunim, për këmbim dhe zhvillim. Tani ka ardhur koha që ta mbyllim, pa dëme dhe duke marrë pa-



rasysh ndjeshmërinë e të dyja palëve për këtë çështje. Ekziston zgjidhje e cila është e pranueshme për të dyja palët, por pa u sulmuar vlerat më të ndjeshme që të dyja palët i kanë rreth kësaj çështje", tha Osmani për "TV Antena", transmeton MIA. Në intervistë theksohet se në Athinë, e ka tran-

smetuar mesazhin se qeveria është e përkushtuar që të gjejë zgjidhje. "Ky kontest zgjati shumë, e bllokoi perspektivën e vendit tim për integrimin në NATO dhe në BE, ndërsa NATO dhe BE kanë një rëndësi vitale për të ardhmen e qytetarëve", sqaroi Osmani. Ai, si në deklaratat për mediat pas takimit,

kështu edhe për televizionin grek "Athina", lidhur me shkrimet në media për emrin "Maqedonia e re" si një zgjidhje të mundshme, tha se ende nuk është arritur deri në atë fazë sa të bisedohet për propozime konkrete. "Ne tani flasim për metodat për qasje, për ndjeshmërinë e problemit dhe për krijimin e kontakteve pozitive dhe për ndonjë hap që ndërkohë duhet të bëhet që të arrihet ky moment i pjekurisë, që të mundet ta mbyllim kontestin", komenton Osmani. Lidhur me atë nëse do të shpallet referendum në Maqedoni, Osmani për "TV Antena" e konfirmoi edhe atë që dje e deklaroi për MIA-n, se në këtë fazë duhet që të fokusohemi për gjetjen e zgjidhjes, ndërsa referendumin duhet ta lemë për më vonë.

## Xhaferi pret të ketë kuorum për Ligjin e shqipes

Shkup, 10 janar - Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi pret që të enjten (sot) do të ketë kuorum kur duhet të votohet për Ligjin për gjuhët. Në emisionin "Otvoreno" në Televizionin 24, Xhaferi duke u përgjigjur në pyetjet tha se pas miratimit të Ligjit për gjuhët do t'i udhëheqë seancat plenare ashtu siç parashikon ligji. "Në shqip apo maqedonisht varësisht nga ajo cilit do t'i drejtohem. Në thelb kjo do të thotë se pas miratimit të ligjit mund ta udhëheqë seancën në gjuhën shqipe, por atij të cilit do t'i drejtohem nëse nuk ka kufje, ndërsa nuk është shqiptar, do t'i drejtohem në atë gjuhë në të cilën do më kuptojë", tha Xhaferi. Lidhur me shpenzimet rruqore dhe keqpërdorimet e bëra nga ana e disa deputetëve, Xhaferi theksoi se Kuvendi nuk ka kompetenca hetuese dhe nuk ka të drejtë të hetojë. Tha se ka ide, por jo edhe propozim apo nisma për ndryshimin e rregulloreve. Lidhur me emrin, tha se Qeveria është ajo e cila është e obliguar t'i zhvillojë negociatat dhe se nëse arrihet marrëveshje ajo do të ratifikohet në Kuvend sepse bëhet fjalë për dokument me karakter ndërkombëtar.

## Dy të vdekur, 13 të lënduar rëndë në Tetovë

Tetovë, 10 janar - Dy persona të vdekur, 13 të lënduar me lëndime të rënda si dhe 68 persona me lëndime më të lehta janë pasojat e gjithsej 80 aksidenteve me këmbësorë, që gjatë vitit 2017 kanë ndodhur në rajonin e Tetovës, informoi zëdhënësi i SPB Tetovë, Marjan Josifovski. Në vitin 2016 në këtë rajon ka pasur katër këmbësorë të vdekur në aksidente, ndërsa numri i të lënduarve rëndë personave me lëndime trupore është në nivel përafërsisht të njëjtë. Sipas të dhënave të Josifovskit, numri më i madh i aksidenteve të vitit të kaluar me pjesëmarrës-këmbësorë kanë qenë pasojë e shpejtësisë së papërshtatshme nga shoferët, respektivisht mosdhënie e përparësisë nga ana e tyre por edhe për shkak të moskujdesit të këmbësorëve. Për përmirësimin e gjendjeve në këtë plan në rrethinën e Tetovës nga ana e SPB Tetovë vitin e kaluar janë zbatuar shtatë kontrolle aksionale në mesin e të cilëve kanë qenë këmbësorët, ndërsa janë organizuar edhe shtatë mësim për aksidente për këmbësorët-kundërvajtës.

PAS "DËSHTIMIT" TË KËSHILLI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

# NJË KËSHILL I RI PËR GJYQËSORIN, ZAEVI MBIKËQYRËSI KRYESOR

Këshilli për reforma në gjyqësor që u formua nga ministri i Drejtësisë dhe nga i cili u dorëhoqën tre anëtarë, do të zëvendësohet me një organ tjetër - Këshill për monitorimin e Strategjisë për reforma në gjyqësor, me të cilin do të udhëheq vetë kryeministri Zoran Zaev



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 10 janar - Këshilli për reforma në gjyqësor, i themeluar në korrik të vitit të kaluar nga Ministria e Drejtësisë, nuk dihet a do të funksionoi më tutje, megjithatë siç njoftuan nga Qeveria, aktivitetet e tija disa mujore kanë dhënë rezultate shumë të mira. E ardhmja e këtij Këshilli fillimisht u kontestua pasi Qeveria, në mbledhjen e fundit vendosi që në fund të muajit janar të themeloi Këshillin për monitorimin e Strategjisë për reforma në gjyqësor, me të cilin do të udhëheq vetë kryeministri Zoran Zaev. Në takimin me gazetarë, zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, nënvizoi se Qeveria u është falënderuar anëtarëve të Këshillit për punën dhe aktivitetet e deritanihme që e kanë realizuar.

"Puna e këtij Këshilli për reforma në gjyqësor, i cili funksiononte në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e formuar nga vetë ministri, kishte detyra specifike të cilat u targetuan në Planin 3-6-9, më konkretisht në pikën 3 dhe 6. Nga ky aspekt, ky Këshill me sukses e ka kryer punën e tij. Tutje si do të funksionojë ky Këshill dhe në çfarë forme, është e drejtë e vetë ministrit", tha Boshnjakovski. Në këtë drejtim, ministri i Drejtësisë, Bilent Saliji, në një prononcim për gazetën KOHA, tha se plotësisht pajtohet me vendimin e Qeverisë dhe se pas konsultimeve me kabinetin qeveritar, ai do të vendos për

të ardhmen e Këshillit për reforma në gjyqësor. "Do të shfuqizohet ose jo, mbetet të shihet. Unë e gëzoj të drejtën e plotë që të formimit të këshillave apo trupave brenda ministrisë. Në periudhën që pason, së bashku do të analizojmë situatën dhe do t'i shqyrtojmë mundësitë se për çfarë lloji të këshillave kemi nevojë në ministri", tha ministri Saliji. Prej detyrave kryesore të këtij Këshilli ishte formimi i Strategjisë për reforma në gjyqësor 2017-2022, respektivisht pakoja e ligjeve reformuese të cilat vetëmse janë futur në procedurë parlamentare. Reagimet dhe qëndrimet e disa anëtarëve të Këshillit për reforma në gjyqësor, ishin se aktiviteti i tyre në këtë trup këshillëdhënës ishte vetëm si dekor dhe asgjë më tepër. Për këtë situatë të krijuar, ministri Saliji theksoi se e drejtë e çdonjërit është të ketë vlerësimet e veta. Mirëpo, ai nënvizoi se puna kryesore është realizuar dhe se anëtarët e Këshillit kanë kontribuar në përgatitjen e shumicës së propozim-ligjeve që pritet të votohen në Parlament. Kontributi i anëtarëve të Këshillit për reforma në gjyqësor, siç njoftuan nga Qeveria, ka qenë në drejtim të përm-

bushjes së pikave 3 dhe 6 të Planit qeveritar, me çka nga fundi i janarit do të kalohet në fazën tjetër të pikës 9. Mes tjerash, nga Qeveria kanë thënë se në asnjë rast nuk kanë shprehur mos besueshmëri ndaj askujt. Periudha që pason, sipas zëdhënësit të Qeverisë, pritet të definojë përbërjen e Këshilli të ri për monitorim të përcjelljes së reformave në gjyqësor, numrin e tyre dhe profilin e anëtarëve. Ndryshe, profesorë të shquar nga sfera juridike, gjykatës dhe prokurorë, gjatë gjashtë muajve të kaluar punuan në përpilimin e një varg ligjesh, të cilat Qeveria i ka cilësuar si hapa themelore drejt reformimit të sistemit gjyqësor në vend dhe kthimit të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji për Këshillin Gjyqësor, respektivisht shfuqizimi i Këshillit për verifikimin e fakteve apo Ligji për gjykatat, prokurorët, paraqesin vetëm një pjesë të gamës së madhe të normave ligjore që Këshilli për reforma në gjyqësor ka punuar gjatë muajve të kaluar. Njëkohësisht, ky Këshill përgatiti edhe Ligji për amnisti, i cili është futur në procedurë parlamentare.

LIGJIN PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE KALON NË QEVERI

## Mbrojtja e informatorëve me standarde ndërkombëtare

Shkup, 10 janar - Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e informatorëve në mbledhjen e fundit të Qeverisë mori pëlqimin që i njëjtit të futet në procedurë parlamentare. Ndryshimi i dispozitave të këtij Ligji, i cili në fuqi është nga nëntori i vitit 2015, synon mbrojtjen e denoncuesve, të drejtat e informatorëve, si dhe veprimet (obligimet) e institucioneve. Me plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve, siç thuhet në propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, pritet të bëhet harmonizimi me standardet ndërkombëtare, gjegjësisht Qeveria në mënyrë të qartë e vërtetoi politikën në luftën kundër korrupsionit. "Qëllimi kryesor i Ligjit në fjalë është harmonizimi i tij me rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Ve-

ncias, respektivisht tejkalimi i anomalive dhe sigurimi i brendshëm i dispozitave ligjore që i rregullojnë kanalet për mbrojtjen e denoncuesve dhe mbrojtjen e informatorëve", thuhet në arsyetimin e Propozim-ligjit. Mes tjerash, pasi këto ndryshime të miratohen në Parlament, denoncuesit dhe informatorët që vijnë do të kenë mundësi që të paraqesin shkeljet ligjore, të cilat lidhen me interesin publik e që ndodhin në sektorin publik apo atë privat. Normat e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve, të cilat deputetët duhet t'i votojnë, po ashtu qartë do t'i definojnë nocionet "institucion" dhe "person juridik". "Nën kuptim 'institucion' mendohet organ i pushtetit qendror apo ai lokal, organ tjetër shtetëror i the-

meluar në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, agjenci, fond, ndërmarrje shtetëror apo publike e themeluar nga shtetët apo komuna, Qyteti i Shkupit apo komuna brenda tij. Nga ana tjetër në nocion 'person juridik' mendohet person juridik i regjistruar në Regjistrin tregtar apo regjistër tjetër i personave juridik, të cilën e udhëheq Regjistrin Qendror i Maqedonisë", thuhet në arsyetimin ligjor. Ndryshe, siç parashihet në këtë Ligj, Komisioni shtetëror për luftimin e korrupsionit është i obliguar të dorëzojë raport para Parlamentit, për pranimin e denoncimeve nga ana e informatorëve në kuadër të raportit vjetor të punës. Mbiqëqyrjet e zbatimit të dispozitave të këtij Ligji do t'i realizojë Ministria e Drejtësisë. (O.XH)

## KRONIKË

### Qafthanë, ndaloheq shtetasi i Maqedonisë për kontrabandë me cigare

Autoritetet Doganore si dhe strukturat e policisë shqiptare ndaluan një shtetas të Maqedonisë, i cili tentoi të kalojë një sasi cigaresh kontrabandë në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës. Siç raporton ATSH, gjatë kontrollit të detajuar janë konstatuar 45 copë steka cigaresh, të cilat po tentoheshin të kaloheshin kontrabandë. Shtetasi me inicialet A.V është marrë në pyetje si i pandehur dhe është arrestuar nën akuzën e veprës penale "kontrabandë me mallra që paguhet akcizë", ndërsa është bllokuar kamioni me gjithë ngarkesën. Materialet i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Pogradec për hetime të mëtejshme.

### Digjet një shtëpi në Mëgllince

U dogj një shtëpi familjare në fshatin malor Mëgllince në Komunën e Nagoriçanit të Vjetër, informuan të mërkurën nga Qendra Rajonale për Menaxhim me Krizat në Kumanovë. Zjarri ka shpërthyer dje në orën, 14. Në shuarjen e zjarrit kanë marrë pjesë njësitë zjarrfikëse nga Nagoreçani i Vjetër dhe Kumanova. Arsyja për shpërthimin e zjarrit dhe dëmet materiale ende nuk dihen.

### Edhe një sulm nga qentë endacak

Në lagjen Aerodrom të Shkupit një burrë i moshuar ka denoncuar në polici se është sulmuar prej një qeni. Siç thekson MPB-ja, personi SH.S (82) nga Shkupi, dje ka denoncuar se më katër janar të këtij viti, rreth orës 15:30 në bulevardin "AVNOJ" është sulmuar nga një qen endacak, i cili e ka kafshuar në një pjesë të këmbës së djathtë.

### Zbulohet identiteti i personit që u gjet në pusët në Sopsishte

Ministria e Punëve të Brendshme informon se ka zbuluar identitetin e personit, trupi i të cilit u gjet i pajetë në pusët Qyteti i Diellit (Sonçev Grad) në afërsi të fshatit Sopsishte. Siç njoftojnë nga MPB, lidhur me ngjarjen e publikuar më 7 nëntor të vitit të kaluar, për gjetjen e një trupi të pajetë në një pusët në Qyteti i Diellit, pas hetimeve dhe autopsisë, është konstatuar se bëhet fjalë për personin Z.P (58) nga Shkupi, i cili më herët u shpall i humbur. Trupi ishte gjetur gjatë kryerjes së punëve ndërtimore në lokacionin Qyteti i Diellit në fshatin Sopsishte. Sipas ekzaminimeve të bëra, u konstatua se trupi i gjetur nuk ka shenja dhune.

### Shkup, shtatë aksidente me 9 të lënduar

Një person është lënduar rëndë, ndërsa tetë kanë marrë lëndime më të lehta në pesë prej gjithsej shtatë aksidenteve të regjistruara në rajonin e SPB Shkup në 24 orët e kaluara. Dy aksidente janë me dëm të evidentuar material, informojnë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Policia e trafikut i ka zbuluar dhe sanksionuar 26 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar në shenjat e komunikacionit. Nga komunikacioni janë përjashtuar 16 shoferë, dy për vozitje nën ndikimin e alkoolit, ndërsa 14 para se të marrin të drejtën e drejtimit të automjetit motorik. Janë sanksionuar edhe katër shoferë për kalimin në udhëkryq në semafor të kuq dhe nga dy për tejkalim dhe rreshtim jo të drejtë. Nga komunikacioni janë përjashtuar 11 automjete me afat të skaduar të lejes për qarkullim, të paregjistruara, për stërngarkim dhe për parregullsi teknike... Për shkak të parkimit jashtë normave me automjetin special "karrotreci" janë mënjanuar 79 automjete.

TRANSPORTI PUBLIK NË DUART E QEVERISË

# TETOVA VUAN PËR TETË AUTOBUSË

Pikërisht mungesa e transportit publik ka bërë që shumë qytetarë të përdorin automjete private edhe për pak punë që kanë në qytet, përdërisa i tërë komunikacioni është përqendruar në pjesën qendrore të Tetovës, ku edhe jo rrallë herë ka kaos në komunikacion, por njëkohësisht do të ndikonte edhe në uljen e ndotjes



në skajin tjetër për të kryer ndonjë punë duhet që të përdorin automjetet. Qytetarët theksojnë se transporti publik do të zgjidhte shumë probleme. "Nuk është normale që një qytet të mos ketë transport urban, sepse qytetarët nuk do të merrnin automjetet, por do të shfrytëzonin transportin, kjo në radhë të parë do të kishte edhe më pak harxhime për vet qytetarët që është aspekti ekonomik, por edhe do të vinte rregull në komunikacion", thotë Blerim Jashari, qytetarë i Tetovës. Në ndërkohë, nga Komuna e Tetovës arsyetohen se kërkesa për tetë autobus e dërguar në qeveri nuk ka marrë përgjigje konkrete. Por nga komuna sh-

prehin optimizëm se Qeveria e re do të gjejë mundësi që Komunës së Tetovës t'i ndajë autobusë.

"Ndërmarrja për transport publik është themeluar, megjithatë në qeverisjen paraprake - ne nuk gjetëm mirëkuptim për këtë çështje. Kërkesa e Komunës së Tetovës ishte që më saktësisht, ashtu siç ju dhuruan Komunës së Shkupit autobusët urban, të gjendet një kompromis që edhe Komunës së Tetovës së paku ti ndahen tetë autobus, gjë për të cilën nuk arritëm një marrëveshje me Qeverinë. Në vizitat që kemi pasur me kryeministrin e ri të Qeverisë reformatore, Zoran Zaev, shpresat janë mjaft optimiste që çdo kërkesë e komu-

nave dhe jo vetëm e Tetovës, në- qoftëse ofrohet projekt - të mund të plotësohet nga ana e Qeverisë. Ne jemi shumë optimist se gjatë pranverës së këtij viti do të mund të gjendet një modus bashkëpunimi me qëllim të funksionalizimit të ndërmarrjes për transport publik, e cila tashmë është jetike për qytetarët e Tetovës", deklaroi Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës.

Ndërmarrja për transport publik tashmë është themeluar në Këshillin e Komunës së Tetovës, por e njëjta nuk është vënë në funksion. "Ndërmarrja ka kaluar në Këshill, do të thotë procedura e themelimit të ndërmarrjes ka kaluar

ARIANIT XHAFERI

**Nuk besoj që Komuna e Tetovës e ka problem të organizojë transportin publik edhe pa ndihmën e Qeverisë, sepse në Ligjin për vetëqeverisje lokale - në kompetencat e komunës parashihet organizimi i transportit publik qoftë ai në pronësi të tërë të komunës, ose në partneritet publiko privat. Besoj se është shumë e lehtë që të organizohet edhe përmes angazhimit të agjencive të shumta turistike të udhëtimeve që ka në Tetovë, e të cilat me siguri se do të ishin të interesuara që të bëhen partner të këtij projekti, mirëpo edhe njëherë mendoj se mungon vullneti dhe paaftësia e tyre për të organizuar trafikun**

tashmë në Këshillin e komunës, megjithatë pa mundësinë e makinerike operative, ajo nuk mund të funksionalizohet, gjegjësisht pa autobusët urban ajo nuk mund të

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 10 janar - Tetova ndoshta në të kaluarën kishte një kompani auto-transportuese që organizonte transport publik dhe jo vetëm brenda territorit të Komunës së Tetovës, por edhe komunat rurale. Tashmë dhjetë vite e kënde, kompania "Polet" nuk funksionon dhe praktikisht, tetovarët nga një skaj

FAZA E PARË E DEBATIT PUBLIK

## VETËM NJË KOMENT PËR LIGJIN E RI TË ARSIMIT TË LARTË

Nga MASH nuk është bërë ende e ditur se cila ka qenë jehona e Propozim-ligjit për arsim të lartë, i publikuar në portalet zyrtare të Ministrisë dhe Qeverisë dhe sa ka shkuar numri i komenteve për tekstin në fjalë. Ndërkaq nga ajo që mund të shihet në "ener.gov.mk", publiku ka qenë thujse indiferent. Është bërë një koment i vetëm, i postuar dy herë, edhe atë për nenin 154 i cili ka të bëjë me kriteret për zgjedhjen në gradën shkencore docent

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 10 janar - Tre javët e kaluara ishin në dispozicion të universiteteve, profesorëve, studentët, por edhe të gjitha palëve të interesit për të komentuar Propozim-ligjin për arsimin e lartë, i cili pritet të miratohet së shpejti. Pas kësaj faze, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) sikurse është bërë e ditur paraprakisht - do të analizojë vërejtjet, sugjerimet dhe eventualisht propozimet e reja për ti inkuorporuar ato në tekstin përfundimtar para se i njëjti ti paraqitet Parlamentit. Në funksion të debatit publik, Propozim-ligji ishte plasuar në vebfaqen e Regjistrimit të Vetëm Nacional Elektronik të Akteve në Republikën e Maqedonisë (ENER) në "ener.gov.mk", ku gjithashtu kanë mund të adresohen komente për tekstin në fjalë.

Nga MASH nuk është bërë ende e ditur se cila ka qenë jehona e Propozim-ligjit për arsim të lartë të publikuar në portalet zyrtare të Ministrisë dhe Qeverisë dhe sa ka



shkuar numri i komentimeve për tekstin në fjalë. Ndërkaq nga ajo që mund të shihet në "ener.gov.mk", publiku ka qenë thujse indiferent. Është bërë një koment i vetëm, i postuar dy herë. Komenti ka të bëjë me nenin 154 me të cilin caktohen kriteret për marrjen e titullin docent. Konkretisht, kundërshtohet vendosja e notës mesatare të kandidatit në shkallën e studimeve të doktoraturës, si dhe numri i publikimeve shkencore. Komentuesja J.K.

kërkon që të mos merret në konsideratë mesatarja e notave të doktoraturës, pasi kandidati është pajisur me gradë shkencore. Ose në rast se nuk hiqet ky kriter, le të merret parasysh edhe mesatarja e notave të magistraturës, pra bashkërisht notat mesatare të dyja cikleve të arsimit pasuniversitar, propozon ai. Ndërkaq, lidhur me publikimet shkencore, i njëjti ngrë dilemën nëse ato janë më të vlefshme se nota mesatare. "Çfarë nëse kandidati ka publikuar më

shumë punime shkencore në Veb, Of, Science ose Skopus. Mos vallë është kandidat më i dobët se dikush që ka mesatare më të lartë të notave, i cili kush e di se si i ka marrë ato nota dhe që ka publikuar në revista të parëndësishme? Prapë se prapë Veb, Of, Science ose Skopus janë revista me renome", shkruhet në komentin e vetëm që është bërë enkas me Propozim-ligjin për arsimin e lartë. Në nenin 154, i cili cakton kushtet e përgjithshme për zgjedhjen në thirrjet (gradat) shkencore, alineja e parë i dedikohet gradës docent. Konkretisht, "kandidati duhet të ketë notë mesatare të paktën tetë në ciklin e parë dhe të dytë, në secilin cikël veç e veç (1); të ketë shkallën shkencore doktor shkencash nga fusha për të cilën zgjidhet docent (2); të ketë të paktën katër publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose në revista shkencore të cilat publikohen në shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe/ose OECD-së sipas kriteve të shënuara në këtë ligji, gjatë

vihet në lëvizje. Varianti është që Komuna e Tetovës kur të pajiset me këto tetë autobusë urban, me linja të cilat nuk do të mund që ti mbulojë - të mund të shpallen në prokurim publik dhe me ato linja të menaxhojnë kompanitë nënkontraktuese, rrjedhimisht private, por meqenëse ne shpresojmë se do të kemi kapacitete të mjaftueshme, nuk do të ketë nevojë për një gjë të tillë", theksoi zëdhënësi Fazliu. Nga ana tjetër, ambientalistët shprehen se mungesa e autobusëve nuk është arsye, sepse ka edhe variante tjera për të organizuar transportin publik. Arjanit Xhaferi nga lëvizja "Eco Guerilla" thotë se organizimi i transportit publik efikas do të ishte shumë më i lehtë për qytetarët të cilët nuk do të duhej të merrnin veturat e tyre për të lëvizur nëpër qytet.

"Nuk besoj që Komuna e Tetovës e ka problem të organizojë transportin publik edhe pa ndihmën e Qeverisë, sepse në Ligjin për vetëqeverisje lokale - në kompetencat e komunës parashihet organizimi i transportit publik qoftë ai në pronësi të tërë të komunës, ose në partneritet publiko privat. Besoj se është shumë e lehtë që të organizohet edhe përmes angazhimit të agjencive të shumta turistike të udhëtimeve që ka në Tetovë, e të cilat me siguri se do të ishin të interesuara që të bëhen partner të këtij projekti, mirëpo edhe njëherë mendoj se mungon vulneti dhe paaftësia e tyre për të organizuar trafikun", deklaroi Xhaferi. Pikërisht, mungesa e transportit publik ka bërë që shumë qytetarë të përdorin automjetet private edhe për pak punë që kanë në qytet, përdërisa i tërë komunikacioni është përqendruar në pjesën qendrore të Tetovës, ku edhe jo rrallë herë ka shumë kaos në komunikacion, por njëkohësisht do të ndikonte edhe në uljen e ndotjes. Përndryshe, zgjidhja e transportit publik mbetet ende vetëm një dëshirë për shkak të aspekteve teknike infrastrukturore ngase shumë rrugë dhe bulevarde janë të ngushta, mos hapja e bulevardeve të reja, mos pasja e pikave të stacioneve ndaluese të autobusëve... prandaj edhe ekziston skepticizëm se për një kohë të gjatë nuk do të zgjidhet problemi i transportit publik.

pesë viteve të fundit para se të shpalljet konkursit për zgjedhje (3); të njëj një gjuhë botërore (4) dhe të ketë aftësi për kryerja të veprimtarisë së arsimit të lartë (5)", shkruhet aty. Në radhë vijjnë kriteret për zgjedhjen në gradën shkencore profesor inordinar, profesor ordinar, ku edhe kriteret e zgjedhjes se vijjnë e bëhen më të larta. Kështu, që dikush të merr titullin profesor inordinar duhet të ketë publikuar ët paktën pesë recensione të punimeve shkencore në revista ndërkombëtare apo edhe të ketë drejtuar ose të ketë qenë pjesëmarrës në projekte shkencore, përdërisa për gradën profesor ordinar kandidati duhet të ketë të paktën gjashtë recensione, të ketë botuar libër, monografi ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore në të cilën bëhet zgjedhja.

Propozim-ligji për arsim të lartë është kombinim i dy teksteve që ishin dërguar në MASH, njëri nga ish-Plenumi i profesorëve dhe tjetri nga një grup profesorësh të Fakulteti Juridik të Universitetit "Kirili dhe Metodi" të Shkup. Zyrtarisht në MASH nuk ishte formuara asnjë komision i cili do të bënte përgatitjen e teksteve apo qoftë edhe formalisht të qëndronin në përbërje të Komisionit për hartimin e atij Propozim-ligjit, sikurse e kërkon tradita. Sidoqoftë, të gjithë ata që nuk kanë qenë dakord me përmbajtjen e tekstit për nxjerrjen e një Ligji të ri në arsimin e lartë, kanë pasur mundësinë të dërgojnë vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në adresën elektronike "zvo@mon.gov.mk" ose me shkrim në arkivin e MASH-it.

## RRITJA E ÇMIMEVE TË KARBURANTEVE NË MAQEDONI

# "HARAÇ" APO ZHVILLIM?

Çmimi i benzinës në Maqedoni është 1.081 euro për një litër që është më shtrenjtë se në Poloni ku paguhet 1.067 euro për 1 litër, ndërsa i afrohet me çmim edhe Luksemburgut ku vozitësit paguajnë 1.180 euro për një litër

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 janar - Vozitësit në Maqedoni dhe rajon i paguajnë çmimet e karburanteve të naftës me çmime të përafërta, por edhe më të shtrenjta se një pjesë e shteteve të Evropës që kanë paga edhe dhjetë herë më të larta se punëtorët në Evropën Juglindore. Çmimi i benzinës në Maqedoni është 1.081 euro për një litër që është më shtrenjtë se në Poloni ku litra paguhet 1.067 euro, ndërsa i afrohet me çmim edhe Luksemburgut ku vozitësit paguajnë 1.180 euro për një litër.

Edhe pse standardi i jetës së qytetarëve dhe fuqia blerëse e popullsisë së vendeve të BE-së, por edhe shteteve të tjera me mirëqenie të madhe në Evropë, është dukshëm më e lartë se standardet e qytetarëve të vendeve të rajonit, në disa shtete të BE-së, karburanti është me çmime gati të barabarta në krahasim me shtetet e rajonit. Pra, qytetarët e Polonisë për një litër euro-super ndajnë 1.067 euro, në Austri ndajnë 1.168 euro ndërsa në Zvicër një litër euro-super kushton 1.257 euro. Bile në një nga shtetet ku qytetarët kanë paga të larta si Luksemburgu, benzinën e paguajnë 1.180 euro për litër.

Çmimin më të lartë të benzinës në rajon e paguajnë qytetarët e Shqipërisë - 1.290 euro për litër, ndërsa qytetarët kroat për një litër benzin paguajnë 1.257 euro. Në Kosovë, një litër benzin kushton 1.050 euro, në Mal të Zi, 1.230 euro, Bosnjë dhe Hercegovinë 0.874 euro, ndërsa në Serbi 1.192 euro. Maqedonia është më e shtrenjtë me 1.081 euro, ndërkohë që vetëm në Bosnje e Hercegovina benzina kushton 0,874 euro për litër.

Në anën tjetër, prodhuesit më të mëdhenj të naftës në botë kanë edhe çmimin më të ulët të karburanteve të naftës. Vozitësit në Algjeri paguajnë 0.165 euro



për litër të benzinës 95 dhe 0,100 euro për një litër të dizelit. Në Kuvajt paguajnë 0.180 për benzinë dhe 0.305 euro për litër të dizelit. Në Libi paguajnë 0.123 euro për benzinë dhe 0.092 euro për litër të dizelit. Në Arabinë Sauditë paguajnë 0.200 euro për litër benzinë dhe 0.167 për litër dizel. Në Tunis paguajnë 0,524 euro për litër benzinë dhe 0.390 euro për litër dizel. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës paguhet 0.535 euro për litër benzinë dhe 0,621 euro për litër dizel, tregojnë të dhënat më të reja të muajit janar të faqes së specializuar për çmimet e karburanteve në botë, Fuel Price.

Sa i përket shteteve të rajonit, Bosnja paguan 0,798 euro për litër dhe Maqedonia me 0.967 poër litër, dhe kanë çmimet më të lira të dizelit. Çmimin më të lartë të dizelit në rajon e paguajnë qytetarët e Shqipërisë -1.268 euro për litër, ndërsa qytetarët kroat për një litër naftë paguajnë 1.204 euro. Në Kosovë, një litër dizel kushton 1 euro, në Mal të Zi, 1.210 euro, Bosnjë dhe Hercegovinë 0.798 euro, ndërsa në Serbi 1.251 euro.

Në Evropë, çmimin më të lartë të karburantit e paguajnë qytetarët e Norvegjisë dhe Hollandës, të cilët për një litër euro-super 95 duhet të ndajë 1.686 gjegjësisht 1.645 euro, kurse për eurodizel në Norvegji paguajnë 1.562 euro për

**“Rritja e akcizës, siç theksuan burime qeveritare për gazetën tonë, është në pajtim me rekomandimet e Bashkimit Evropian, që të destimulohet përdorimi i karburanteve dizel në favor të mjedisit jetësor. Megjithatë, pritet që në fund të vit nga ky "haraç" i ri për qytetarët në arkën e shtetit të derdhen 30 milion euro shtesë që nuk do të harxhohen për mbrojtjen e ambientit, por për projekte kapitale**

litër. Ndryshe, kostoja e karburanteve të naftës, në shtetet e ndryshme të botës varren, përveç nga luhatjet e çmimit të naftës në bursat botërore, edhe nga subvencionimet e ndryshme, kursi i dollarit, shkallës së tatimit në vlerë të shtuar si dhe taksave të ndryshme që paguhen krahas çmimit themelor të naftës.

Ndonëse, karburantet përbëjnë produktet më të rëndësishme që i nënshtrohen taksës së akcizës në Maqedoni por edhe shtetet e tjera, prandaj janë edhe një burim shumë i rëndësishëm i mbushjes së arkës së shtetit. Madje, në Maqedoni nga fillimi i vitit për çdo litër të dizelit paguhet edhe 3.5 denarë akcizë shtesë. Rritja e akcizës, siç theksuan burime qeveritare për gazetën tonë, është në pajtim me rekomandimet e Bashkimit Evropian, që të destimulohet përdorimi i karburanteve dizel në favor të mjedisit jetësor. Megjithatë, pritet që në fund të vit nga ky "haraç" i ri për qytetarët në arkën e shtetit të derdhen 30 milion euro shtesë që nuk do të harxhohen për mbrojtjen e ambientit, por për projekte kapitale në arsim, për kopshetet e fëmijëve, biblioteka, zhvillim rajonal të barabartë, investime kapitale në komuna, shëndetësi dhe sfera të tjera.

## Ekonomia këtë vit me rritje prej 3.2 për qind

Shkup, 10 janar - Rritja e ekonomisë së Maqedonisë gjatë këtij viti do të jetë 3.2 për qind, parashikoi Banka Botërore në raportin më të ri për perspektivat ekonomike. Sipas BB, në Maqedoni pas tejkallimit të krizës politike, e cila pati ndikim në ekonominë, probleme kryesore mbeten papunësia, konsolidimi fiskal dhe mundësia për rritjen e

deficitit fiskal për shkak të shpenzimeve të paralajmëruara për projekte infrastrukturore. Me projeksionin BB për vitin e ardhshëm parashihet rritje e BPV të Maqedonisë prej 3,9 për qind dhe prej 4 për qind në vitin 2020. Si edhe në raportin e rregullt vjeshtor për ekonominë në EJT, BB parashikon rritje prej 1,5 për qind të ekonomisë së Maqedoni-

nisë në vitin 2017. Prej vendeve të rajonit, sipas BB, Shqipëria këtë vit do të ketë rritje prej 3.6 për qind, BeH 3.2 për qind, Bullgaria 3.3 për qind, Kroacia 2.6 për qind, Mali i Zi 2.8 për qind, Serbia 3 për qind, ndërsa Kosova 4.8 për qind. BB vlerëson se ekonomia globale sivjet do të përmirësohet dhe parashikon rritje prej 3.1 për qind.





"Neve nuk na intereson pjesa tjetër, përveç asaj që e kërkojnë ligjet. Mjafton që drejtorët dhe zëvendësit e tyre t'i përmbushin kushtet e parapara ligjore. Opinioni është dëshmitarë që dy ndërmarrje publike në kuadër të Qytetit udhëhiqen nga kuadro shqiptarë. Unë dhe LSDM, stereotipat për një etnikum të caktuar i kemi tejkaluar", tha Shilegov

AKSION GJENERAL PËR PASTRIMIN E SHKUPIT

# ANËTARËT SHQIPTARË EMËROHEN SË SHPEJTI



me drejtorët e Ndërmarrjeve Publike "Higjiena Komunale" dhe "Parqe dhe Gjëlberimi", gjatë ditëve në vijim do të pastrojnë pjesë të ndryshme të Çairit dhe më pas komunave tjera. Drejtori i NP "Parqe dhe Gjëlberime", Abdusamed Jashari, tha se në këtë aksion janë të kyçur me të gjitha kapacitetet teknike dhe kadrovike. Krahas pastrimit dhe rregullimit të gjëlberimit, ai nënvizoi se ky aksion synon ngritjen e vetëdijes qytetare për kujdesin më të madh ndaj të mirës publike.

Njëkohësisht, drejtori i NP "Parqe dhe Gjëlberime", Adrian Muça, tha se ndarja e qytetit dhe mirëmbajtja selektive e hapësirave të gjëlberuara në Qytetin e Shkupit do t'i takojë të kaluarës. Brenda këtij viti, sipas drejtori Muça, shërbimet e NP "Parqe dhe Gjëlberime" do të rregullojnë çdo cep të rrugëve në qytetet, përfshi Komunën e Çairit dhe Sarajin.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 10 janar - Plotësimi i vendeve të lira të anëtarëve shqiptarë në Këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike në Qytetin e Shkupit dhe zëvendësit e drejtorëve, pritet të zgjidhen në seancën e ardhshme të Këshillit të Qytetit të Shkupit. Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, gjatë fillimit të aksionit gjeneral për pastrimin e komunave në kryeqytet, tha se administrata e re e qytetit ka nevojë për njerëz që i përmbushin kualifikimet ligjore. "Neve nuk na intereson pjesa tjetër, përveç asaj që e kërkojnë ligjet. Mjafton që drejtorët dhe zëvendësit e tyre t'i përmbushin kushtet e parapara ligjore. Opinioni është dëshmitarë që dy ndërmarrje publike në kuadër të Qytetit udhëhiqen nga kuadro shqiptarë. Unë dhe LSDM, stereotipat për një etnikum të caktuar i kemi tejkaluar", tha Shile-

gov. Gazeta KOHA ditë më parë njoftoi se këshilltarët e LSDM-së në Qytetin e Shkupit i kanë dorëzuar emrat e anëtarëve për Këshillat drejtues në Ndërmarrjet Publike që funksionojnë nën kompetencat e Qytetit. Tashmë 56 anëtarë në këshillat drejtues - që të gjithë maqedonas janë caktuar, ndërsa 14 të tjerë - shqiptarë, pritet të emërohen gjatë ditëve në vazhdim. Numri i plotë anëtarëve në këto Këshilla varion nga ndërmarrja në ndërmarrje, me çka lista përfundimtare e këtyre përbërjeve pritet të dihet pasi që të

zgjidhen këto anëtar.

Në aksionin gjithëpërfshirës për ndotjen e ajrit, i cili filloi nga

Çairi, mori pjesë edhe kryetari i kësaj Komune, Visar Ganiu. Ai me këtë rast bëri të ditur se së bashku

## ÇAIR PA KRYETAR KËSHILLI

Ndonëse kanë kaluar më tepër se 2 muaj nga raundi i tretë i zgjedhjeve lokale në Çair, kjo komunë edhe më tutje nuk e ka zgjedhur kryetarin e Këshillit. Sipas autoriteteve komunale, për momentin këshilltarët komunal vendosin dhe miratojnë vendime vetëm në interes të përgjithshëm, siç është rasti i Buxhetit dhe ndarjes së mjeteve financiare për rrogat e edukatorëve në kopshtet e fëmijëve. Për



këtë çështje, kryetari i Çairit, Visar Ganiu, tha se zgjedhja e kryetarit të këshillit komunal pritet të bëhet së shpejti, pa precizuar se kur do të ndodhë kjo. "Ne vlerësojmë se duhet të bisedojmë të më gjithë këshilltarët komunal të Çairit dhe jam i bindur se këto bisedime së shpejti do të japin rezultate dhe kryetari i Këshilli do të zgjidhet", tha Ganiu.

AFATI DERI MË 15 MARS

## Edhe këtë vit dorëzohen fletëparaqitjet për tatimin e të ardhurave

Shkup, 10 janar - Qytetarët këtë vit për herë të fundit do t'i dorëzojnë fletëparaqitjet për tatim në Drejtorinë për të Ardhura Publike për realizimin e të ardhurave plotësuese gjatë vitit të kaluar. Sipas ndryshimeve të Ligjit për tatimin personal të të ardhurave, të cilat hynë në fuqi nga 1 janari i këtij viti, prej vitit të ardhshëm, do të marrin fletëparaqitje të plotësuar vjetore që e jep Drejtorja për të Ardhura Publike, ndërsa tatimpaguesi vetëm do të vërtetojë. Për të ardhurat e realizuara në vitin 2017 tatimpaguesi mund të dorëzojë fletëparaqitje për tatim deri më 15 mars të këtij viti. Mund të dorëzohet në sportelet e DAP, në mënyrë elektronike ose përmes postës.

Për të ardhurat e realizuara në vitin 2017 tatimpaguesi mund të dorëzojë fletëparaqitje për tatim deri më 15 mars të këtij viti. Mund të dorëzohet në sportelet e DAP, në mënyrë elektronike ose përmes postës

kanë për obligim të paraqesin nëse kanë realizuar të ardhura nga dhënia me qira e objektit banesor ose honorar në bazë të marrëveshjes autoriale, për fitimin e realizuar nga lojërat shpërblyese mbi 5.000 denarë, dividendë... Tatimpaguesi nuk dorëzon fletëparaqitje për tatim nëse realizon vetëm të ardhura nga paga, pensioni, veprimtaria bujqësore apo veprimtaria e pavarur. Viteve të fundit fletëparaqitje për tatimin kanë dorëzuar mbi 400.000 qytetarë. Në vitin 2017, për vitin 2016 të ardhura plotësuese kanë paraqitur 439.689 qytetarë të cilët në mënyrë vullnetare i kanë paraqitur 173.592.004.847 të ardhura vjetore bruto dhe 10.133.228.081 tatim personal të të

ardhurave. Të ardhurat, të cilat qytetarët i realizojnë në vend dhe jashtë vendit tatimohen me tatim personal të të ardhurave me shkallë prej 10 për qind. Për vitin e ardhshëm janë paralajmëruar ndryshime në tatimin personal dhe vendosje e shkallës më progresive të tatimit, e cila do të thotë se më të pasurit duhet të paguajnë më shumë. Vlerësohet se ndryshimet e planifikuara do ta rrisin shkallë e pagesës së tatimit personal për 40 për qind. Sipas Ligjit, nëse tatimpaguesi nuk dorëzon fletëparaqitje për tatim deri më 15 mars 2018, atëherë do t'i shqiptohet gjobë për shkeljen e bërë. Për dorëzimin jo në kohë, gjegjësisht për mosdorëzimin e fletëparaqitjes

dhe për të ardhura të cilat nuk janë paraqitur në tërësi gjoba lëvizë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë denari. Tatimpaguesve, të cilët duhet të paraqesin të ardhura plotësuese deri më 15 mars të këtij viti, lëshuesi i të ardhurave duhet deri më 25 janar t'u japë përllogaritjen. Sipas ndryshimeve të Ligjit për tatimin personal të të ardhurave prej janarit të këtij viti vendoset procedurë e re për përllogaritjen dhe shlyerjen e obligimeve për tatimin personal të të ardhurave, gjegjësisht përllogaritja e tatimit do të bëhet me dorëzimin e Përllogaritjes elektronike për të ardhura dhe tatim (e-PAT) në Drejtorinë për të Ardhura Publike, përmes sistemit të ri e-tatimi personal.

# Ç'DUHET TË PRESIM NGA 2018-A, NË TË KATËR CEPAT E BOTËS

**AMERIKAT: PERHAPJA E EFEKTIT TRUMP.** Kanadaja në rritje. Ndërkohë që SHBA-ja balafaqohet me një udhëheqës izolacionist, shumë jopopullor, Kanadaja bën në kontrast të fortë. Në nivelet 3%, rritja e GDP parashikohet të tejkalojë vendet e tjera të zhvilluara. Kryeministri Justin Trudeau ka premtuar një axhendë të vitit 2018 për barazinë gjinore, bashkëpunimin mbi ndryshimet klimatike dhe një fokus mbi paqen globale. Ka tashmë shenja të një "ikje të trurit" në fushën e teknologjisë nga SHBA-ja, dhe investitorët parashikojnë një bum të kompanive teknologjike në Toronto.

**FUNDI I NAFTA-S?** Negociatat për të ribërë marrëveshjen e tregtisë mes SHBA, Meksikës dhe Kanadasë do të marrin vrull vitin që vjen. Qëllimi është që të ketë një marrëveshje nga pranvera, para zgjedhjeve në Meksikë dhe SHBA. Por është e vështirë të shihet se si të tre vendet mund të zgjidhin dallimet ideologjike mbi atë që duhet të arrijë një NAFTA e re. Administrata e Trump ka si përparësi reduktimin e deficitit tregtar të SHBA, ndërsa Kanadaja dhe Meksika besojnë se tregtia e lirë duhet të mbetet përparësia kryesore. Kriza ekzistenciale e Amerikës vazhdon. Nëse ky vit u duk i rrëmujshëm për amerikanët, pritni të shihni vitin 2018. Me një seri sprapjesh në fushën rregullatore dhe emërime jo të zakonshme qeveritare në 2017, administrata e re ka krijuar terrenin për sulme ndaj të drejtave të grave dhe pakicave, mjedisit dhe sundimit të ligjit. Ndërkohë, një hetim i FBI-së për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale do të hetojë më thellë në Shtëpinë e Bardhë, duke nxitur ndoshta politika dhe postime më kaotike në Twitter.

**EFEKTI TRUMP NË MEKSIKË.** Reagimi ndaj retorikës së presidentit Trump për mexikanët mund të sjellë zgjedhjen e një populist të majtë në presidencë vitin e ardhshëm. Andrés Manuel López Obrado është përpara kandidatëve të tjerë në sondazhet e fundit. Nëse ai fiton zgjedhjet e korrikut, me siguri do të jetë më sfidues ndaj pozicioneve të SHBA mbi imigrimin dhe trafikun e drogës, se sa paraardhësi i tij. Kjo mund të shtojë tensionet mes dy

fqinjëve.

**RIKTHIMI I CHAVIZMIT.** Në fillim të këtij viti, presidenti i Venezuelës, Nicolás Maduro, dukej në prag të rënies, mes mangësive në ushqime dhe demonstratave masive në rrugë. Tani, pasardhësi i Hugo Chavez duket i gatshëm të mbajë pushtetin e tij për disa vite të tjera. Në 2017, Maduro mënjanoi kundërshtarët politikë duke zëvendësuar Asambleen Kombëtare me një Asamble të re Kushtetuese, të kontrolluar nga mbështetësit e tij. Ai pritet të kandidojë për president në 2018 dhe tashmë ka ndaluar disa parti opozitare nga garimi. Nëse ky proces zgjedhor do të jetë si zgjedhjet e fundit lokale, ai do të fitojë.

**EUROPE: UDHEHEQËSIT E HERSHEM DO TE MBAHEN PAS PUSHTETIT.** Shkundja politike në Rusi. Rezultati i garës presidenciale në Rusi, në mars, nuk është në dyshim. Vladimir Putin do të vazhdojë edhe gjashtë vjet në presidencë. Por ka shumë gjëra për të parë: Sa mbështetje do të marrë Ksenia Sobchak – nominisht një kandidate e opozitës, por që mendohet të jetë një kukull e

Kremlinit? A do të arrijë aktivisti Alexey Navalny të ringjallë protestat anti-qeveritare? Dhe ndoshta më e rëndësishmja, kush do të jetë kryeministri i Putinit? Marrja e një lojtari serioz pushteti do të sugjeronte që Putini t'eston pasardhësin e tij të mundshëm; qëndrimi i Dmitry Medvedevit mund të nënkuptojë se ai nuk mund të vendosë; dhe një ekonomist serioz mund të sinjalizojë planin e Putinit për të rikthyer në formë qeverisjen e zvogëluar të Ruisë. Natyrisht, zgjedhja e një askushi do të thotë se ai po zgjedh një besnik – ashtu siç bëri Jelcini me Putinin

**GJERMANIA DEL NGA QORRSOKAKU POLITIK.** Ekonomia më e fuqishme e Evropës pritet të fillojë vitin në një formë të mirë, me papunësi me rekord të ulët. Ajo gjithashtu hyn në 2018 me një qeveri kujdestare dhe një Angela Merkel të dobësuar. Për të shmanhur zgjedhjet e menjëhershme dhe për të filluar mandatin e saj të katërt, Merkel do të duhet të krijojë një koalicion ndërpartiak në janar dhe socialdemokratët ka gjasa të kërkojnë rritje të investi-

Pas turbulencave dhe tensioneve të 12 muajve të fundit, 2018 mund të jetë viti që mund të shkundë gjithçka: negociatat për Brexit mund të prodhojnë një plan real, status quo-ja në Korenë e Veriut mund të marrë fund, dhe zgjedhjet lokale nga India në SHBA, mund të ofrojnë referendume për udhëheqësit kombëtarë kontroversë. Rajon pas rajoni, ja ç'mund të presim nga viti që po vjen:



meve vendase. Duke parë përtej kufijve të Gjermanisë, Merkel ka thënë se është plotësisht e angazhuar të shtyjë përpara me reformat "ambicioze" të BE.

**RRITJE E TENSIONEVE MES SPANJËS DHE KATALUNJËS.** Katalunja autonome ka një histori të gjatë përpjekjesh për t'u larguar nga Spanja, por kriza e këtij viti tregon se nuk ka gjasa të shkëputet plotësisht. Pas shkarkimit të qeverisë katalanase dhe vendosjes së sundimit të drejtpërdrejtë këtë vit, qeveria qendrore e Spanjës do t'i lejojë rajonit të votojë për një qeveri të re në vitin 2018. Tensionet do të ngrejne pyetje të mëdha rreth trajtimit që Spanja i bën rajonit dhe më gjerë, në lidhje me reagimin e BE-së ndaj këtyre çështjeve lokale plot tension.

**REALITETI I BREXIT.** Mbetet edhe pak më shumë se një vit, për të zgjidhur pjesët më komplekse të largimit të Britanisë nga BE-ja: tregtia, shërbimet financiare, imigracioni dhe siguria. Londra tashmë ka humbur kohë dhe ka bërë hapat e gabuar në përpjekjen e saj për t'u ndarë nga

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 10 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

blloku, kështu që nuk ka gjasa që një Brexit i vërtetë të ndodhë deri në afatin përfundimtar, të marsit 2019. Në vend të kësaj, ndoshta do të shohim një periudhë tranzicioni, edhe pse asnjëra palë nuk mund të pajtohet me gjatësinë e tij. BE gjithashtu po përgatit një marrëveshje tregtie të lirë, të ngjashme me atë të Kanadasë.

**AFRIKA: PREMTIMET PER NDRYSHIM.** Franca shton angazhimin në Afrikë. Tërheqja e Amerikës nga skena diplomatike botërore në vitin 2017 lejoi shumë aktorë të tjerë që të provonin të dilnin në qendër të vëmendjes, duke përfshirë presidentin francez Emmanuel Macron. Që nga zgjedhja e tij në maj, Macron ka vizituar katër herë Afrikën, duke premtuar ndryshime dhe duke premtuar të ndërtojë inovacion, në vend të ndihmës për zhvillim. Në vitin 2018, me ndihmën e Arabisë Saudite dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, Macron premtoi të ndihmojë në luftimin e grupeve të armatosura në rajonin Sahel, të evakujë emigrantët afrikanë nga Libia dhe të luftojë trafikimin e qenieve njerëzore.

**RRITET PRESIONI PËR FUSHATAT.** Sudani i Jugut, Egjipti dhe Zimbabveja janë disa prej vendeve që do të zhvillojnë zgjedhje presidenciale në vitin 2018. Fushata në dy nga ekonomitë më të mëdha të Afrikës, Afrikën e Jugut dhe Nigeri, janë vetëm fillimi: Presidenti Muhammad Buhari i Nigerisë, i cili ka qenë i sëmurë dhe jo në detyrë prej muajsh, do të përgatitet për rizgjedhje në shkurt 2019. Dhe pas vonesave të përsëritura, Republika Demokratike e Kongos do të mbajë zgjedhje në dhjetor 2018. Pyetja e madhe: Pas 16 vjetësh në pushtet, presidenti Joseph Kabila, a do të bjerë dakord të largohet?

**AZIA: TENSIONET E VITIT QE KALOI SHNDERROHEN NE AKSION PLOT TELASHE.** Diçka duhet të ndodhë në Korenë e Veriut. Nuk është kurrë e lehtë të bëhen parashikime për Korenë e Veriut. Por 2018 duket sikur do jetë viti kur status quo-ja merr fund – në një mënyrë ose në një tjetër. Negociatat diplomatike mund të kenë një shans tjetër, administrata Trump mund të nisë një sulm parandalues, ose ndoshta bota do të dorëzohet para një Koreje të Veriut bërthamore. Tajvani mund të tërheqë vëmendje të padëshiruar. Kongresi amerikan sapo ka miratuar Aktin e Autorizimit Kombëtar të Mbrojtjes, i cili autorizon vizita të ndërshjella nga anijet e marinës midis Tajvanit dhe Shteteve të Bashkuara në vitin 2018. Kina ka paralajmëruar se do të pushtonte Tajvanin nëse anijet luftarake të SHBA-ve do të bënin vizita portuale atje dhe po zhvillon patrullime përreth Tajvanit në javët e fundit. Duke qenë se Pekini gjithashtu dyshon se presidenti i Tajvanit Tsai Ing-ven dëshiron të shpallë zyrtarisht pavarësinë, shtimi i forcave ushtarake të saj në Detin e Kinës Jugore ka gjasa të nxisë nevojën e pushtimit të Tajvanit.

**ËNDRRA GLOBALISTE E KINËS.** Në mars, udhëheqësi i gjithëpushtetshëm i Kinës Xi Jinping pritet të ngarkojë një skuadër të re udhëheqëse në poste kyçe, dhe ta shndërrojë vizionin e tij për Kinën në një plan real, në takimin e përvitshëm "Dy Seanca". Vitin që vjen, Xi do të vazhdojë të synojë liderhipin e globalizimit, pavarësisht se vendet shohin me sy dyshues shtimin e influencës së Kinës. Korea e Veriut, Tajvani dhe Deti i Kinës së Jugut do të mbetet në krye të agjendës së Pekinit, ashtu si dhe marrëdhënia e saj dashuri-urrejtje me Trumpin, i cili kohët e fundit e shpalli Kinën një "fuqi rivale".

**INDIA: ZGJEDHJE, ZGJEDHJE, ZGJEDHJE.** India përgatitet për 2019. Viti i ardhshëm do të shohë një seri zgjedhje lokale në prag të zgjedhjeve të mëdha: zgjedhjet e përgjithshme të Indisë në vitin 2019. Këto sondazhe të hershme do të shihen si një referendum mbi kryeministrin Narendra Modi dhe performancën e tij deri më tani. Pavarësisht nga premtimet e tij, ekonomia e tretë më e madhe e Azisë nuk po ecën me forcë të plotë. Viti gjithashtu do të jetë vendimtar për Kongresin kombëtar indian të opozitës.

**ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË PAKISTAN.** Partia e kryeministrit të rrëzuar Navaz Sharif do të konkurrojë me djalin e Benazir Bhuttos, Bilawal, dhe ish lojtarin e cricket-it, Imran Khan përpara shtatorit. Zgjedhjet në vend nuk janë vetëm për politikanët, votuesit dhe kutitë e votimit. Ushtria e fuqishme e Pakistanit dhe gjeneralët e saj, që dikur kishin prirje për grushte shteti, do të shohin me kujdes. Po kështu do të bëjnë edhe fqinjët, Afganistani dhe India, dy vende që aktualisht përballen me grupe terroriste, që dikur përkrahehin nga Islamabadi. (Quartz)

## Vjedhjet më të mëdha bëhen konform Ligjit



Nga Artan FUGA

Vjedhjet e mëdha nuk bëhen duke anashkaluar dhe shkelur ligjet në fuqi. Vjedhjet më të mëdha bëhen konform ligjit, i cili legjitimon vjedhjen duke e shndërruar atë në "politika ekonomike".

Këtu fillon dhe mbaron puna.

Vjedhjet në shkelje të ligjit janë krejt të papërfillshme në krahasim me vjedhjet konform ligjit.

Vjedhja më e madhe është pabarazia pronësore, në të ardhura, në pasuri, në status social, midis shqiptarëve të sotëm e krijuar nga viti në vit, mbi pabarazitë që kishte krijuar tanimë shoqëria totalitare.

Midis atyre që i kanë lënë pa brekë, i atyre që nuk kanë lekë as të shkojnë një javë me pushime, atyre që nuk mund të blejnë as edhe një palë pantallona jashtë tregtisë të Gabit, atyre që masin çdo lek për të blerë preshë, qepë, domatet e fundit, dhe të nginjurve, diferencat janë si ato midis sheikëve të naftës në Lindje dhe të papunëve të periferive të qyteteve perëndimore.

Të gjitha këto pabarazi kriminale brenda një lagjeje, një qyteti, një shoqërie.

Ka mbaruar sensi i drejtësisë sociale, pra nuk ka vend për drejtësi ju-

ridike, sepse drejtësia juridike pa drejtësi sociale, është padrejtësi ulurite.

Këtë veting bëni në fillim!

I dini ju këto pabarazi kriminale!!!

I boton njeri?

Jo, sepse del ndonjë kapobandë bregalanase dhe konsideron se pabarazitë në kapitalizëm janë të mira dhe duhen shtuar edhe më shumë, dhe se të revoltohesh ndaj tyre është punizëm, populizëm, a kanibalizëm.

Qelbësira!

Kurrë kombi shqiptar nuk ka qenë në gjendje kaq të pabarabartë.

Apo i kanë me meritë!

Nuk përjashtohen biznesmenët e ndershëm. Aspak. Atyre ju qoftë e hajrit!

Por, politikat që bazohen në rritjen stratosferike të barazive ekonomike dhe shoqërore janë kriminale.

Ato zhvasin popullin dhe shkatërojnë edhe bizneset prodhuese sepse nuk ka blerje.


Kanabizimi rural nuk është asgjë para tyre!

Ata që nuk jetojnë veçse duke rumbullakosur me uri muajin janë budallenj, dembela, parazitë, të mështë, të leshtë!

Po, o mashtruesia po!

(Koha Jonë)

Vjedhjet në shkelje të ligjit janë krejt të papërfillshme në krahasim me vjedhjet konform ligjit. Vjedhja më e madhe është pabarazia pronësore, në të ardhura, në pasuri, në status social, midis shqiptarëve të sotëm e krijuar nga viti në vit, mbi pabarazitë që kishte krijuar tanimë shoqëria totalitare.



# GARDIANËT E REVOLUCIONIT, një shtet brenda shtetit!

Një ushtri prej të paktën 125.000 njerëzish, një ekonomi paralele prej qindra miliard dollarësh, një forcë që i përgjigjet vetëm Ajatollahut të Madh

Kanë futur në "kllapë" Presidentin reformist. Operojnë në krah të ushtrisë së Bashar al-Assad, rivendikojnë fitoren kundër milicive të ISIS-it, sfidojnë Amerikën dhe Presidentin e saj që i quan krahun e armatosur të një shteti terrori. Tani kërcënojnë Evropën. Janë Gardianët e Revolucionit Iranian, Pasdaranët në shërbim të shefit të vetëm që e njohin me të vërtetë: Ajatollahut të Madh Ali Khomeini. Një shtet brenda shtetit, me një ushtri prej të paktën 125.000 vetash, me një ekonomi paralele prej qindra miliard dollarësh.

Kur diplomacia tregon muskujt dhe lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera, në Iran pasdaranët kthehen të mbretërojnë. Atëherë ja Zëvendëshefi i Gardianëve Revolucionarë Iraniane, Gjeneral Brigade Hossein Salami, që paralajmëron se nëse Evropa do ta kërcënojë Teheranin, pasdaranët do ta rrisin rrezën e raketave të tyre në mbi 2000 kilometra. "Nëqoftëse e kemi mbajtur rrezën e raketave tona në 2000 kilometra kjo nuk i detyrohet mungesës së teknologjisë: po ndjekim një doktrinë strategjike", ka thënë Salami, i cituar nga agjencia iraniane FARS. "Deri më tani kemi ndërjerë se Evropa nuk përbën kërcënim, kështu që nuk e kemi rritur rrezën e raketave tona. Por nëqoftëse Evropa dëshiron të bëhet kërcënim, atëherë do ta rrisim rrezën e raketave tona".

Në këtë kontekst, pushteti i "reformatorit" Rohani është në fakt i kufizuar, fuqimisht i kushtëzuar në veprimin e tij. "Amerikanët dhe sionistët e dinë mirë sesa përcaktues është roli i IRGC-së sin ë mbrojtjen e vendit, ashtu edhe në mbështetje, në nivel ndërkombëtare, të aleatëve të Republikës Islamike". Kështu është shprehur Ali Akbar Velayati, Asistent i Ajatollahut Khomeini, në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve lidhur me



shtimin e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara kundër Iranit dhe Islamic Revolutionary Guard Corps. "Sot iranianët - djem, vajza, burra dhe gra - janë të gjithë IRGC, të vendosur bashkë me ata që na mbrojnë ne dhe rajonin kundër agresionit dhe terrorit", i ka bërë jehonë Javad Zarif, Ministri i Ja-

shtëm iranian. Më 22 prill, duke përkujtuar 38 vjetorin e themelimit të Gardianëve Revolucionarë, Gjeneral Mohammad Bagheri, President i Komandës së Forcave të Armatosura të Iranit, ka deklaruar se IRGC-ja, "ka vepruar si "mburojë sigurie" e kombit Iranian dhe e të gjithë myslimanëve



ja ka ristrukturuar hierarkinë e saj në 2008 për të fuqizuar kontrastin e protestave popullore, duke krijuar një strukturë komandimi të pavarur për çdo provincë në gjendje të shtypë revoltat publike. Në koordinim me IRGC-në, edhe Basij-ët (milicia vullnetare e mobilizimit) marrin pjesë në represion. Trupa Basij i përdor njësitë e veta paraushtarake dhe rrjetin e vet të spiunazhit në universitete, shkolla, zyra administrative, fabrika dhe lagje për të identifikuar e arrestuar disidentët.

Përveçse në luftën 8 vjeçare midis Iranit dhe Irakut, IRGC-ja ka luajtur një rol të dorës së parë në konfliktet e hapura në Lindje të Mesme, nga Siria në Irak, nga Jemeni në Liban. "Siria është provinca jonë e 35-te", shpalli në 2014 Mehdi Taeb, ish Komandant i IRGC-së. Kurse sot janë pasdaranët e "Forcës Al Quds", repartet e Gardianëve të Revolucionit që operojnë jashtë vendit, që kanë kontrollin e disa bazave dhe aeroporteve ushtarake siriane si ato të al-Sin, T4, Domair dhe Mez-zeh (Damasco). E "Forcës Al Quds" është pjesë Njësia 400, që në të kaluarën ka goditur apo ka tentuar të godasë objektiva izraelite e amerikane nëpër botë. Bëhet fjalë për rreth 3000 agjentë të zgjedhur, ndërsa pasdaranët janë rreth 125000.

Më shumë se një ushtri në vetvete, Gardianët veprojnë si një shtet brenda shtetit. Drejtuesi politik i tyre është Ajatollahu Ali Khomeini, kreu i tyre në terren është Gjenerali Mohammad Ali Jaafari. Kredoja e tyre, e shpallur në më shumë se një intervistë për gazetë iraniane, është: "Irani ka arritur në një kapitull të ri të politikës së tij të eksportimit të revolucionit islamik jashtë vendit. Revolucion i islamik po përparon me shpejtësi të mirë. Jo vetëm Palestina dhe Libani kanë njohur rolin influent të Republikës Islamike, por edhe popujt e Irakut e Sirisë. Edhe ata e vlerësojnë kombin e Iranit. Faza e eksportimit të revolucionit ka hyrë në një erë të re. Hizballahu dhe rezistenca e tij kundër një prej ushtrive më të forta të botës është një prej mrekullive të Revolucionit Islamik. Është pjesë e influencës së fuqishme të sistemit islamik si timonier i rajonit. Irani korr suksese të vazhdueshme në strategjinë e tij të eksportimit të Revolucionit Islamik në Lindje të

nëpërmjet pranisë së saj në Siri e në Irak".

Sipas statutit të saj, IRGC-ja "është një entitet nën komandën supreme të Liderit" dhe ndjek politikisht e ideologjikisht velayat-e faqih (sistemin e pushtetit të mullahëve)" (përkatësisht nenet 1 e 47). Rezistenca iraniane ka evidentuar herëpasëherë se IRGC-ja është leva kryesore dhe organi qendror i mullahëve për të imponuar ushtarakisht darën e tyre represive. Në 38 vitet e fundit, Gardianët e Revolucionit kanë luajtur rolin kryesor në represionin e brendshëm, përfshi masat e përgjakshme kundër revoltës studentore të 1999 dhe revoltën kombëtare e 2009. Inteligjenca e IRGC-së është bërë një organ trishtueshmërisht i njohur si protagonist arrestimesh, torturash, ekzekutimesh dhe vrasjesh të disidentëve e të spiunazhit kundër fraksioneve të vetë regjimit. IRGC-



Mesme". Është ai që ka një kontroll të fortë mbi të paktën gjysmën e milicive shiite irakene, al-Hashd al-Shaabi. 100.000 njerëzve në Irak u duhen shtuar 50.000 të tjerë në Siri, midis sirianësh, irakenësh, shiitësh afganë e pakistanezë, dhe po aq të Hizballahut në Liban. Në total pothuajse dyfishi i pasdaranëve iranianë, 125.000, përfshi 25.000 që operojnë në repartet raketore dhe në Gjirin Persik. Ajo e tyre është një ushtri paralele: më efçente dhe më mirë e armatosur se ajo "zyrtare": Në fakt, Gardianët kanë një aviacion, një marinë dhe një këmbësori të tyren.

Pasdaranët, që e kanë pasur provën e zjarrit gjatë konfliktit kundër Irakut, me kalimin e kohës kanë siguruar një pushtet të madh mbi shoqërinë iraniane. Mitit të ngritjes së klasave më të varfra, nga ku kanë nxjerrë legjitimitet të fortë, i është bashkangjitur duke filluar nga fillimet e viteve '90, një pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në ekonomi dhe në prodhimin industrial të vendit. Kjo trupë e shton pushtetin e saj ushtarak, të nënshtruar forcave të armatosura, një penetrim kapilar në të gjithë asetet kryesore e ekonomisë iraniane, aq sa një raport i RAND Corporation i vitit 2009 e quante "një konglomerat të pasur socio-politiko-ekonomik, influence e të cilat shtrihet praktikisht në çdo cep të jetës politike dhe të shoqërisë iraniane". Në kompleks, pasdaranët kontrollojnë një rrjet kompanishë dhe fondacionesh me të ardhura vjetore të vlerësuara në 12 miliard dollarë.

Asesti më i rëndësishëm në profilin ekonomik (telefonja mobile, tunelet nëntokësore për centralet atomike, kërkimi universitar dhe industria ushtarake e atomike kanë një rëndësi më shumë strategjike sesa ekonomike) është Komanda e Ndërtimeve Khatam Ol Anbia, e cila monopolizon të gjithë tenderat për infrastrukturën. Njëpërmjet praktikës së nënkontraktimit, pasdaranët jo vetëm që sigurojnë fitime të konsiderueshme financiare në të zezë, por garantojnë edhe kontrollin e të gjitha kompanive të ndërtimeve private të vendit. Nuk mjafton. Në 8 vitet e presidencës së Mahmoud Ahmadinejad, Gardianët kanë siguruar shfrytëzimin e disa vendburimeve të gazit në South Pars, rezerva më e madhe e botës, dhe përmjet fondacioneve të tyre kanë siguruar aktivitetet industrial dhe tregtare për një vlerë të vlerësuar në 120 miliard dollarë. Midis këtyre kompania shtetërore telefonike (8 miliard dollarë) dhe janë akaparuar tenderë publikë të rëndësishëm si metroja e Teheranit me kompaninë e ndërtimeve Khatam Ol Anbia.

Fondacioni i të Shtypurve (Bonyad Mostazafan) dhe Fondacioni i Martirëve dhe i Veteranëve (Bonyad Shahid va Omur-e Janbazan) janë dy institucionet më të mëdha ekonomike të vendit. Të dy kontrollohen nga ish anëtarë të ushtrisë, të ardhur nga rangjet e pasdaranëve. Gjithë kësaj i shtohen të ardhurat e aktiviteteve "në të zezë", si shitja e produkteve perëndimore. Është "Pasdaran Economy": prodhon pasuri që krijon konsensus dhe u jep një motivim konkret të rinjve rrënjëshkullor për t'u rekrutuar në ushtrinë e Gardianëve: para dhe identitet. Të njëjtat leva me të cilat "Kalifati islamik" kishte ngritur pasuritë e tij. I pajisur me këtë pushtet, ushtarak dhe financiar - që reformisti Rohani nuk ka arritur ta shkulë dhe të koperturës "ideologjike" të Ajatollahut Khamenei, Gjeneral Jaafari ndërhyrë rëndshëm në krizën libaneze dhe Kryeministrit hariri që kërkon çarmatimin e Hizballahut, ai i përgjigjet prerë: "Nuk është argument i negociueshëm". Ka që flasin për "ISIS shiit". Një gjë është e qartë: në Iran ndryshim presidentët, zgjidhen edhe reformatore si të tillë, por pushteti i Gardianëve nuk preket, bile konsolidohet më shumë dhe eksporton "revolucionin" e tij. (bota.al)

# NACIONALIZMI QË VJEN NGA LINDJA

Ku qëndron problemi në BE? Polonia dhe Hungaria - të pranuar jo më larg se 13 vjet më parë në BE - sillen në mënyrë nacionaliste. Një pasqyrë e gjendjes së një problemi që ka kohë që rëndohet



Dëshmi tjetër për të konfirmuar besimin në vetvete të evropianlindorëve as që ishte e nevojshme. Por Viktor Orbani, burri i fortë i Hungarisë dhe kryeministri, e shfrytëzoi paraqitjen e tij të shkurtër tek CSU-ja bavareze për të shqiptuar fjalë të qarta: refugjatët myslimanë janë për bashkëkombasit e tij pushtues myslimanë, "një gjë të tillë nuk e duam". Dhe Hungaria nuk ka dëshirë që t'i imponojnë asgjë, u shpreh Orbani për gazetën bulevardeske "Bild". Ai nuk pranon ndërhyrje, përkundrazi vendi i tij meriton respekt, bubulloi ai kundër kritikës së kryetarit të SPD-së, Martin Schulz. Pa dyshim: vendet e BE po distancohen politikisht nga njëri-tjetri.

## NJË DEBAT TJETËR VLERASH NË LINDJE

Kjo në një kohë kur BE ka qenë adresë e ëndërruar e ish-bllokut lindor. Nga kjo kanë kaluar 25 vjet. Ndërkohë, lidhja evropiane e shteteve ka probleme masive me anëtarët e saj më të rinj. Kjo mund të pohohet edhe për palën tjetër. Polonisë dhe Hungarisë, BE i duket vetëm makinë parash e shkëlqyer. Centralizmin e Brukselit ata e kundërshtojnë. Në multikulturalizmin e Evropës Perëndimore ata shohin kërcënim. Në vend të kësaj, në Varshavë dhe Budapest përkufizohen vlera të reja të vjetra: atdheu, besimi i krishterë, familja. Ideale politike shoqërore si këto vlejën edhe në Çeki dhe në Sllovakia. Është formuar një kundërlëvizje ndaj shoqërive të hapura të Evropës Perëndimore.

Pas kësaj qëndron ideja, për t'i dhënë sërish përparësi kombit në një ekzistencë pa kufi, të globalizuar. Me këtë, Viktor Orbani dhe partia e tij Fidesz i përkufizojnë nga e para standardet e vlerave. Kemi të bëjmë me një përpjekje për ta bërë më të thjeshtë një botë që është ndërlikuar dhe që kolektivi e ndjen si kërcënim. Të njëjtin kurs ndjek edhe Jaroslaw Kaczynski, kryetar i Partisë PIS në Poloni. Orbani e ka pagëzuar "shtet joliberal" vendin e tij, Kaczynski e quan ristrukturimin e shtetit "dobra zmiana", një ndryshim të mirë.

Të krijohet përshtypja se ideja evropiane po ripërkufizohet në Lindje.

## MUNGESA E SOCIALDEMOKRACISË PAS SOCIALIZMIT

Pasoja është një zhvendosje e qartë nga e djathta në periferinë lindore të BE. Kjo ka të bëjë vetëm kushtimisht me vështirësitë ekonomike. Supozimi se një shoqëri e tronditur nga krizat dhe papunësia e lartë nxit mendësinë nacionaliste, është nga ky shkak, pak bindës po të shohësh Çekinë. Një rritje ekonomike prej gati pesë përqind dhe një kuotë papunësie spektakulare prej vetëm tre përqind, më e ulëta në BE, nuk e penguan zhvendosjen djathtas nën kryeministritin Andrej Babis. I ngjashëm është edhe zhvillimi në Poloni. Në vitin 1990, një polak prodhonte mesatarisht vetëm një të dymbëdhjetën e asaj që prodhonte mesatarisht një gjerman, në vitin 2016 kjo kuotë arriti në një të tretën. Megjithatë, nacionalizmi po avancohet. New York Times është e sigurtë "Populism lives in East Europe". Se pse kemi një situatë të tillë, kjo ka të bëjë shumë me faktin se shoqëritë e transformimit të Lindjes nuk kaluan pas vitit 1990 një epokë socialdemokratike, argumenton Piotr Buras, një politolog i njohur i Polonisë. Neoliberalizmi e goditi thuasj pa kufizim shoqërinë e atomizuar nga komunizmi. Një shtet social nuk ekzistonte, sindikatat qenë të dobëta. Kapitalizmi hyri pa u amortizuar. Kjo ka lënë gjurmë plagësh, që duket për shembull në një kompleks inferioriteti që vazhdon deri sot. Në Poloni, thotë shkrimtari Ziemowit Szczerek, e shohin veten po ashtu si e shikon Perëndimi Poloninë: "pak të varfër, pak të prapambetur, dhe pak efikasë".

## POLONIA: NJË LLOJ TENDENCE PËR AUTIZËM

Javën e kaluar (3.1.) kryeministri i ri i Polonisë, Mateusz Morawiecki bëri vizitën e tij prezantuese në botën e jashtme - jo në Bruksel, por në Budapest. Kjo është një deklaratë e qartë politike; Hungaria është më e rëndësishme për Poloninë se BE. Pas kësaj ai vizitoi homologun e tij në Sllovakia. Zëra për t'i

kthyer kurrizin Brukselit vërtet që nuk dëgjohej, por përsa u përket lidhjeve të brendshme ndaj BE, Varshava sillet si e huaj ndaj familjes së BE. Shumë njerëz janë të mendimit, thotë shkrimtarja Inga Iwaszow, se "BE na merr dinjitetin". Nga Perëndimi, sipas tyre, vijnë vetëm "kufizime, probleme dhe relativizim moral". Tema për të cilat në Perëndim ka konsensus, si barazia e të drejtave, laicizimi dhe të drejtat e minoriteteve në Poloni nuk kanë mbërritur kurrë, thotë Iwaszow.


## HUNGARIA: IDENTITET I PASIGURTË NACIONAL

E ngjashme është gjendja në Hungari. Kryeministri Orbani ka vendosur në drejtësi dhe administratë në mënyrë sistematike pasues të tij. Michael Ignatieff, drejtues i Central European University në Budapest thotë se përfytyrimet se pas kthesës politike të viteve 1990 Hungaria do t'u afrohet idealeve perëndimore të një kushtetute demokratike, të ekonomisë së tregut dhe të multikulturalizmit, qenë të gabuara. Edhe në Hungari lufta e kulturave të lejon të shikosh thellë në identitetin kolektiv. Vetëm në vitin 1920 u bë shtet i pavarur Hungaria, duke dalë nga Monarkia Habsburgase. Rikujtimi i "vlerave hungareze" nga Orbani u sugjeron shumë vetëve mbështetje dhe siguri. Ajo është një botë "pa të huaj, pa njerëz modernistë ekologjistë dhe nëpunës të Brukselit", shkruhet në revistën "Spiegel".

Atë që mund të vërehet aktualisht në periferitë lindore të BE, nuk e përfytyronte shumica e mendjeve të zgjuara të BE para më shumë se 25 viteve. Pranimi i standardeve demokratike dhe të ekonomisë së lirë të tregut - me apo pa komponentë socialë - konsiderohej i vendosur. Madje brenda pak vitesh. Këtë e kundërshtoi më 1990 sociologu gjerman Ralf Dahrendorf. Për ndërtimin e një shoqërie demokratike, liberali parashikoi 60 vjet. Dhe pikërisht nxënësit shembullorë ndër anëtarët e rinj të BE, Polonia dhe Hungaria duket se po e konfirmojnë rrugën e gjatë për harmonizimin e Evropës.

Në Shqipëri ndodh që edhe raportin e invaliditetit ta marrësh me mik. Jo vetëm ekonomia, por sidomos korrupsioni e zhvillimi i ngadalshëm e shuajnë shpresën tek rinia. Pandalshëm ajo kërkon alternativa jashtë Shqipërisë

Orest Çipa, 29 vjeç, është shef i Sektorit të Koordinimit të 24 Njësi-ve Administrative, që ka Bashkia e Tiranës, më e madhja në Shqipëri, me më shumë se 757 mijë banorë. Ai nuk e di nëse do të vazhdojë të punojë në Bashki apo jo në vitin që po vjen, 2018. Në ditët e para të janarit ai do të merret në intervistë nga Zyra për Çështjet Konsullore në Ambasadën Amerikane në Tiranë, pasi ka fituar aplikimin në Llotarinë Amerikane për të jetuar dhe punuar legalisht në SHBA. "Në Bashkinë e Tiranës ka hapësira të mëdha për t'u rritur profesionalisht, për të pasuruar përvojat. Puna në Bashki më jep mundësi të njoh mirë problemet që kanë qytetarët dhe parë nga afër sesi funksionojnë gjërat në realitet. Të punosh në Bashkinë e Tiranës është një mundësi e shkëlqyer", thotë për DW, Orest Çipa. Por ai po përpjetet ta lërë këtë mundësi - edhe pse vetë e quan të shkëlqyer - për të shkuar drejt të panjohurës, ëndrrës amerikane. I arsimuar në universitetin e Tiranës për gazetari, ai ka kryer një master 3 vjeçar për Drejtësi dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Shangait, me përvoja të mira pune brenda dhe jashtë Shqipërisë, ka krijuar familjen e tij, është prind i një vajze të vogël. Megjithatë ai nuk ndihet i plotësuar në Tiranë. Gotën e tij në Shqipëri e sheh gjysëm bosh. "Ka shumë faktorë që më bënë të aplikoj për të fituar Lotarinë Amerikane dhe u larguar nga Shqipëria. Janë faktorë ekonomikë por edhe të tjerë që nuk kanë të bëjnë me ekonominë. Ka një zhvillim të ngadalshëm shoqëror, emancipues, demokratizues. Psh ndiej një rënie të peshës, fuqisë së qytetarëve që i kërkojnë llogari qeverisjes dhe duan një rol më të madh. Ende indeksi i korrupsionit është goxha i lartë, ndër më të lartët në Ballkanin Perëndimor. Këtu ndodh që edhe raportin e invaliditetit, kur je invalid, duhet ta marrësh me mik.



# LARGIMI I TRURIT, SHKAK EKONOMIA DHE SIGURIA PUBLIKE



OREST ÇIPA

**E di që ikja e njerëzve të arsimuar nga Shqipëria do të ketë një kosto të jashtëzakonshme në progresin ekonomik dhe social të vendit. Por kur mungojnë kushtet për të zhvilluar karrierën dhe ndjekur vokacionin tënd, i çfarëdo lloji qoftë ai, nuk të mbetet gjë tjetër vetëm të largohesh. Mendo rininë që jeton në qytete të vogla Kavajë, Tepelenë, Himarë, Laç, etj, ku nuk ndodh asgjë dhe ku nuk ka punë, çfarë mund të bëjnë përveç se të kërkojnë të largohen?**

Dihet që sa më i lartë korrupsioni, aq më e lartë përqindja e njerëzve të arsimuar që kërkojnë të largohen. Korrupsioni fiton terren në kurriz të ndërtimit të një shoqërie të bazuar në merita. Ka edhe faktorë të tjerë që lidhen me jetën e përditshme", thotë Orest Çipa.

## "IKJA E TRURIT"

### ME PËRMASA SHQETËSUESE

Faktorët e tjerë i identifikon vetë Qeveria Rama 2. Në Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Migracionin, 2018-2024 krahas faktorit ekonomik janë identifikuar edhe faktorët e tillë si: "niveli i ulët i sigurisë publike, mungesa e besimit të qytetarëve në përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore". Në Strategjinë Kombëtare, e përmendur më lart, vihet në dukje se fenomeni i largimit të trurit, i njohur si Brain Drain, i shfaqur në vitin 1990, menjëherë pas rënies së regjimit komunist, ka vazhduar edhe gjatë tranzicionit të vështirë post-komunist dhe nga viti në vit përmasat e tij janë bërë shqetësuese. Kjo pasi largimi i trurit nuk përfshin vetëm akademikët apo personat e kualifikuar të fushave të tjera. "Një numër i madh studentësh shqiptarë shkojnë në Itali dhe Greqi dhe më pas "truri" i vendit largohet drejt Gjermanisë, SHBA dhe Kanadasë" vihet në dukje në këtë dokument të Ministrisë së re të Diasporës. Në Shqipëri nuk ka shifra të sakta zyrtare, lidhur me numrin e akademikëve, specialistëve, elitës intelektuale që është larguar për të jetuar dhe punuar në Perëndim. Dy

destinacionet e preferuara SHBA dhe Kanada përtej Atlantikut e kanë futur në sistem marrjen e trurit përmes lotarive të përvitshme. Ndërsa në Gjermani po shkojnë të jetojnë dhe punojnë në mënyrë të ligjshme mjekë dhe infermierë të kualifikuar, pasi për ta ka nevojë. Shifrat e përafërta bëjnë fjalë për largimin e 1/3 së popullsisë së Shqipërisë.

### PASOJA TË RËNDA PËR SHQIPËRINË

Largimi i ajkës së intelektualëve dhe sidomos e rinisë ka pasoja të rënda: Shqipërisë i ikën pjesa më e mire e kapitalit njerëzor, lokomotiva e zhvillimit të saj ekonomik dhe social. "Ikja e rinisë po tkurr aktivitetin dhe efektivitetin prodhues në sektorin privat dhe po ngadalëson ritmet e procesit të afrimit të Shqipërisë me BE, proces i vlerësuar si katalizator i emancipimit shoqëror, zbatimit të ligjit dhe i kryerjes së reformave të mëdha. Mendo rininë që jeton në qytete të vogla... ku nuk ndodh asgjë dhe ku nuk ka punë, çfarë mund të bëjnë përveç se të kërkojnë të largohen?", thotë Orest Çipa. "E di që ikja e njerëzve të arsimuar nga Shqipëria do të ketë një kosto të jashtëzakonshme në progresin ekonomik dhe social të vendit. Por kur mungojnë kushtet për të

zhvilluar karrierën dhe ndjekur vokacionin tënd, i çfarëdo lloji qoftë ai, nuk të mbetet gjë tjetër vetëm të largohesh. Mendo rininë që jeton në qytete të vogla Kavajë, Tepelenë, Himarë, Laç, etj, ku nuk ndodh asgjë dhe ku nuk ka punë, çfarë mund të bëjnë përveç se të kërkojnë të largohen?", thotë Orest Çipa. Që të kërkojnë të realizohesh si individ, të aspirosh një jetë më të mirë, është një nga të drejtat themelore të njeriut, kur kjo ndodh pa thyer ligje dhe rregulla të vendit pritës. Qeveria Rama 2 në hartimin e Strategjisë Kombëtare për të ndaluar fenomenin e Brain Drain dhe kthyer atë në Brain Gain ka vendosur nxitjen dhe promovimin e emigracionit të përkohshëm dhe atij qarkullues për individë të kualifikuar dhe talentuar. Këtë qëllim do t'i shërbejnë marrëveshjet me SHBA dhe Kanadën për nxitjen e kthimit vullnetar në Shqipëri të emigrantëve të kualifikuar. Atyre do t'u jepet mundësia të vijnë në Shqipëri dhe qëndruar pak kohë për konsultime, dhënie leksionesh, trajnime, gjë që do të bëjë të mundur njëherazi regjistrimin e gjithë kapaciteteve intelektuale jashtë vendit. Ndërsa të rinjë dhe të rejave të talentuar do t'u ofrohen bursa për të studiuar jashtë vendit dhe vende pune, kur të mbarojnë studimet.

## Fillon kompensimi i viktimave të krimit

Komisioni për kompensimin e viktimave të krimit i themeluar nga Ministria e Drejtësisë, ka marrë vendim me të cilin ka aprovuar kërkesat për kompensimin e viktimave të krimit të parashtruara nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimë të Viktimave e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Komisioni e ka aprovuar kërkesën për kompensim të viktimës së krimit të iniciuar nga Zyra e mbrojtësve të viktimave të rajonit të Prishtinës. Kërkesa është paraqitur për çrregullime të rënda të shëndetit mendor, shpenzime mjekësore dhe të hospitalizimit,



si pasojë e veprave penale "trafikimi me njerëz", nga neni 171 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 33

të Kodit Penal të Kosovës, dhe veprave penale "shërbime seksuale" të viktimës së trafikimit nga neni

231 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilat janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar të dënuarit që kanë kryer veprat penale të lartcekura. "Komisioni për kompensimin e viktimave të krimit, ka shqyrtuar kërkesën dhe ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitjen e saj, siç janë lloji i veprës penale që është kryer ndaj viktimës, mos realizimi i kërkesës pronësore juridike nga i dënuari në procedurën penale dhe kushtet tjera formale e materiale të raportit me dispozitat e neneve 7 dhe 8 të Ligjit për kompensimin

viktimave të krimit, si dhe dispozitat e neneve 4 paragrafi 2 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ, për mënyrën e kompensimit përfshirë edhe llogaritjet e kompensimit për dëmtimet e shumëfishta", thuhet në komunikatën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2017 është kompensuar viktimë e parë e krimit nga rajoni i Mitrovicës, e iniciuar nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimë të Viktimave. Me këtë rast ka filluar për herë të parë implementimi në praktikë i Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

# FËMIJËT E ISIS-IT, ATA QË NUK PATËN MUNDËSI TË ZGJEDHIN

Shumë gra, të cilat qenë bashkuar me të ashtu-quajturin Shteti Islamik u martuan me xhihadistë ose lindën fëmijë të tyre. Një pjesë e tyre edhe udhëtuan shtatzëna në Irak ose në Siri ose morën me vete fëmijët me të rritur. Në publikun gjerman u ngrit me shpejtësi zëri që atyre, që kthehen, t'u merren fëmijët. Për Nora Fritzsche-n ky nganjëherë është qëndrim i nxituar. Pengesat për të larguar fëmijët nga familja janë shumë të larta, thotë ekspertja e specializuar për parandalimin e radikalizimit të Organizatës Fëmijët dhe Mbrojtja e Fëmijëve (AJS) për Rinin Verior-Vestfalinë. "Për këtë duhet të ekzistojë një rrezikim konkret i fëmijës". Që prindërit i përkasin një drejtimi islamist, kjo nuk mjafton. "Ajo që vlerësohet është e mira e fëmijës, jo ajo që mendojnë prindërit". Fritzsche e sheh Ndihmën Sociale për të Miturit e Rrezikuar para një dileme. Pu-

nonjësit vërtet që shohin shpesh që fëmijët nuk rriten në kushte të mira, "por institucionet nuk kanë të drejtë që të garantojnë për çdo fëmijë mbështetjen më të mirë, as edhe një edukim të mirë". Përpara se ta largojë një fëmijë nga familja Zyra e Ndihmës për të Miturit, ajo ka edhe mundësi të tjera si këshillimin e familjes ose përkujdesjen por për këtë familjet duhet të jenë dakord dhe të bashkëpunojnë.

## ZYRA E NDIHMËS PËR TË MITURIT DHE KRITERET

Veç rrezikimit të fëmijëve me anë të abuzimit fizik dhe shpirtëror ose abuzimit seksual ka edhe tipare të tjera, të cilat mund t'i takosh tek familjet salafiste ngjashëm si te sektet: "Kur fëmijët izoloohen fort dhe rriten në rolin e një personi të huaj për ambientin, kur ata duhet të rrinë në distancë nga persona të besimeve të tjera, kur punohet me frikë ose kur fëmijët nuk arrijnë të zhvillojnë personalitetin për shkak

të rregullave tepër të ngurta dhe kufizohen në autonominë e tyre". Që prindërit kanë kryer shkelje penale kjo nuk do të thotë detyrimisht një rrezikim i fëmijës. Gjykatat gjermane aktualisht janë gjithsesi të mendimit që gratë, vetëm me praninë e tyre tek IS nuk kryejnë aktin penal të anëtarësisë në një organizatë terroriste. Sepse ndryshe nga meshkujt, zakonisht ato nuk duhet të bëjnë betim për besnikëri.

## PËR SA FËMIJË BËHET FJALË?

Prokuroria Federale nga ana tjetër dëshiron të veprojë më me ashpërsi kundër këtyre grave, meqenëse sipas mendimit të saj, ato e forcojnë nga brenda milicinë terroriste: si bashkëshorte të luftëtarëve të IS dhe si nëna, që i rrisin fëmijët me ideologji terroriste. Ajo mendon se këta fëmijë njohin vetëm terrorin. Por me këtë pozicion, Prokuroria Federale gjermane ka dështuar njëherë para Gjykatës së Lartë Federale. Po të ndryshojë



Më e vona që prej tatëpjetës së Shtetit Islamik në Siri dhe në Irak është diskutuar se si duhet vepruar në Gjermani me të kthyerit e milicisë terroriste - para së gjithash me fëmijët

kjo, do të kishim të bënim me një ndryshim të ndjeshëm në sjelljen ndaj mirëqenies së fëmijës. Sipas qeverisë gjermane, një ndër pesë vetë nga 960 vetët që kanë shkuar te IS në Siri dhe Irak që prej vitit 2012, janë gra. Një e treta e këtyre të larguarve është kthyer në Gjermani, midis tyre rreth 50 gra. Siç mësoi Deutsche Welle, ekspertët

besojnë se çdo grua e larguar kthehet me të paktën një fëmijë. Në përgjigjen e një Pyetjeje me Shkrim të Grupit Parlamentar të të Gjelbërve, qeveria federale shkruan se ajo pret "një numër treshifror të vogël të miturish" që të kthehen, "dhe pjesa më e madhe e tyre duhet të jetë në moshë foshnjore ose të jenë fëmijë të vegjël".

## Cili do të jetë roli global i Britanisë pas BREXIT-it?

Ndërsa afrohet dalja nga Bashkimi Evropian në vitin 2019, Britania po përpiqet të përcaktojë një rol të ri në arenën botërore. Shumë analistë thonë se Londra mund ta ketë të vështirë që ta ruajnë ndikimin e saj, ndërsa fuqitë botërore kërkojnë një përfaqësim më të gjerë në organizma globale si Kombet e Bashkuara. Por siç njofton nga Londra korrespondenti i Zërit të Amerikës, Henry Ridgwell, qeveria britanike këmbëngul se po përpiqet të ndërtojë aleanca globale përtej Evropës. Një sekretar i jashtëm britanik e kishte përshkruar dikur rolin e vendit të tij në arenën ndërkombëtare si më ambicioz sesa kapaciteti i tij ekonomik. Por Britania duket se po e humbet këtë rol.

"Të dalësh nga Bashkimi Evropian do të thotë se Mbretëria e Bashkuar mund të konsiderohet si një ekonomi e mesme në një botë gjithnjë e më të polarizuar, ku ka tani blloqe masive ekonomike. Bëhet fjalë për Shtetet e Bashkuara, Kinën, Bashkimin Evropian. Në shekullin e ardhshëm, do të konkurrojnë edhe India, Amerika e Jugut që po fuqizohet, si edhe

**Analistët thonë se në përpjekjet për një rol të rij në arenën botërore, Britanisë do t'i duhet të lidhë aleanca të reja, duke mbajtur ndërkohë pranë miqtë historikë dhe duke punuar për të vendosur stabilitet brenda vendit**



Afrika. Cili do të jetë vendi i Britanisë?, thotë Luke McDonagh i Universitetit të Qytetit të Londrës. Sipas tij, një shenjë e ndikimit në rënie ishte humbja e vendit të një gjykatësi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Pas një beteje të gjatë në Kombet e Bashkuara, Londra e tërhoqi kandidatin e saj. Një gjykatës indian zuri vendin që Bri-

tania e kishte patur që nga krijimi i këtij organizmi në vitin 1946. "Sot loja e pushtetit është shumë ndryshe nga ç'ishte në vitin 1945. Dhe na duhet të shtrojmë pyetjen nëse Këshilli i Sigurimit do të vazhdojë në këtë formë për një kohë të gjatë". Por shumë analistë thonë se nuk ka gjasa që Britania ta humbasë vendin e përhershëm në Kë-

shillin e Sigurimit në të ardhmen e afërt. "Shumica e fuqive të mëdha në Këshillin e Sigurimit, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Kinën, nuk duan reforma serioze për institucionin në të ardhmen e afërt", thotë Richard Gowan i Këshillit Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë. Britania këmbëngul se ambicia e saj pas Brexit-it është që të

krijojë një "Britani Globale".

"Nga njëra anë, shërbimi i huaj britanik do të jetë më shumë në gjendje të investojë më shumë burime në çështjet e Kombeve të Bashkuara, tani që nuk do të jetë aq i fokusuar tek Bashkimi Evropian. Por nga ana tjetër, pa mbështetjen e 27 anëtarëve të tjerë të BE-së, britanikët do ta kenë shumë më të vështirë që të ushtrojnë ndikim në debatet për çështjet humanitare, të zhvillimit ose sigurisë përmes OKB-së". Një gjë e tillë u vu re në qershor, kur shumë vende të BE-së nuk votuan pro-Britanisë për një rezolutë lidhur me pretendimin e saj mbi Ishujt Chagos në Oqeanin Indian. Gowan thotë se Britanisë i duhet mbështetja e Evropës. "Nëse britanikët do të japin përshtypjen se thjesht po afrohen me amerikanët, do të sakrifikojnë shpejt vullnetin e mirë të partnerëve evropianë". Analistët thonë se në përpjekjet për një rol të rij në arenën botërore, Britanisë do t'i duhet të lidhë aleanca të reja, duke mbajtur ndërkohë pranë miqtë historikë dhe duke punuar për të vendosur stabilitet brenda vendit.

(VOA)

Në bazë të Vendimit për publikim të Shpalljes publike për zgjedhje të Drejtorit të NP "Jasmin" Kavadar nr. 09-91/1 të datës 09.01.2018, ndërsa në pajtim me nenin 19-a paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16),

Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon

**SHPLLJE PUBLIKE**  
**Për zgjedhje të drejtorit të NP "Jasmin" Kavadar**

Në bazë të nenit 23 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16),

Për drejtor mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit

-në momentin e emërimit me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune.

-posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë.

-ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Krahas dokumentacionit nga pika 1, kandidatët e interesuar duhet të parashtrorin edhe Program për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes së NP "Jasmin" Kavadar.

Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Dokumentet e arritura i shqyrton Komisioni i treanëtarësh i zgjedhur nga Kryetari i Komunës në afat prej 8 (tetë) ditëve dhe pas kalimit të Shpalljes tërë dokumentacionin e parashtron deri te Kryetari i Komunës, i cili në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve sjellë Vendim për zgjedhje.

Lajmërimi për zgjedhjen e realizuar deri te kandidatët do të dorëzohet në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e parashtrimit të Vendimit për zgjedhje.

Kryetari i Komunës do të mbajë të drejtën që kandidatët me fletëparaqitje në gjendje të rregullt t'i intervistojë.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrorët deri në Arkivin e Komunës së Kavadarit (me shenjë: "Për Shpallje") në adresën në vijim: Sheshi "Marshall Tito" pn Kavadar.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev

Në bazë të Vendimit të Këshillit nr. 08-4875/12 për delegim të kompetencave të Komunës së Kavadarit për organizim dhe realizim të manifestimeve kulturore sipas Programit për aktivitete të Komunës së Kavadarit nga sfera e kulturës në vitin 2018, nenit 4 të Rregullores nr. 08-4875/13 për mënyrën dhe procedurën për delegim të kompetencës së Komunës së Kavadarit për organizim dhe realizim të manifestimeve kulturore sipas Programit për aktivitete të Komunës së Kavadarit në sferën e kulturës për vitin 2018 të subjektit juridik, nenit 113 paragrafi 1 pika 20 e Statutit të Komunës së Kavadarit (Fletorja zyrtare e Komunës së Kavadarit nr. 08/05), Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon,

**KONKURS**

**Për delegim të kompetencave të Komunës së Kavadarit për organizim dhe realizim të manifestimeve kulturore sipas Programit nga sfera e kulturës për vitin 2018 të subjektit juridik**

Delegohen kompetencat për organizim dhe realizim të manifestimeve kulturore të parapara me Programin për aktivitete të Komunës së Kavadarit nga sfera e kulturës për vitin 2018 edhe atë:

**1. Manifestimi ekonomik kulturor "Shën Trifuni" – 14 shkurt 2018**

**2. Manifestimi kulturor ekonomik turistik "Tikveshki Grozdober" – shtator**

**3. Viti i Ri – dhjetor**

Obligim i subjektit juridik është që në tërësi të planifikojë, organizojë, realizojë dhe menaxhojë manifestimet kulturore.

Shuma e mjeteve financiare nga Buxheti i Komunës së Kavadarit për kompetencën e deleguar gjendet në Programin për aktivitete të Komunës së Kavadarit nga sfera e kulturës për vitin 2018.

Së bashku me fletëparaqitjen subjekti juridik duhet të parashtrorë:

1. Vendim për regjistrim nga Regjistri qendror

2. Emri i plotë i subjektit që realizon aktivitetet nga kompetenca e deleguar.

3. Përshkrim të detajuar të aktiviteteve, bartësit dhe afatet për realizim të kompetencave të deleguara – programi për mënyrën dhe procedurën për kryerje të kompetencës së deleguar.

4. Struktura financiare e aktiviteteve.

5. Emri, mbiemri dhe numri i amzës së personave të angazhuar për kryerje të kompetencave të deleguara, struktura e tyre kualifikuese dhe përvoja profesionale.

6. Emri, mbiemri dhe kontakt telefoni i personit përgjegjës për realizimin e kompetencave të deleguara.

Për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e ndërsjella për realizimin e kompetencave të deleguara mes Komunës së Kavadarit dhe subjektit juridik do të lidhet marrëveshje në pajtim me Ligjin për marrëdhënie obligative.

Projektet e propozuara, krahas arsytimit dhe të përmbajnë edhe propozim konstruksion financiar në të cilën do të theksohen mjetet që kërkohen nga Buxheti i Komunës së Kavadarit si dhe mjetet e sigurura nga Ministria e Kulturës së RM, të ardhurat personale si dhe burime të tjera.

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim projektet me konstruksion financiar duhet të parashtrorin domosdo në formular të posaçëm – Fletëparaqitje që mund të merret në verzion elektronik në ueb faqen e Komunës së Kavadarit [www.kavadarci.gov.mk](http://www.kavadarci.gov.mk).

Subjektet e interesuara juridike fletëparaqitjet me të dhënat e lartpërmendura mund t'i parashtrorin në Komunën e Kavadarit në afat prej 7 ditëve nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik, në arkiv përmes postës në adresën:

**Komuna e Kavadarit**

**Sheshi Marshall Tito nr. 2, Kavadar**

**Me shenjë "Konkurs – Kultura 2018"**

Fletëparaqitjet së bashku me të dhënat e paplotësuara si dhe ato të cilat nuk do të parashtrorin në afatin e caktuar, nuk do të merren parasysh.

Nr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ viti

Kavadar

KOMUNA E KAVADARIT  
Kryetari i Komunës  
M-r Mitko Jançev

Në bazë të nenit 30 dhe nenit 37 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12 dhe 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe nenit 11 të Ligjit për muzetë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 66/04, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15, 39/15) dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002), Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon,

**SHPLLJE PUBLIKE**

për zgjedhje të drejtorit të Muzeut lokal Galeria – Kavadar

1. Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Drejtorit të Muzeut lokal Galeria – Kavadar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

- të ketë të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror, Shkencat shoqërore (Fakulteti filozofik – grupi histori, fakulteti për historinë e artit me arkeologji, fakulteti për arkeologji me histori të artit, fakulteti për etnologji, fakulteti i artit figurativ).

- në momentin e emërimit me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në sferën e veprimtarisë së muzeve ose galerive.

-posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë.

-Kandidati për drejtor është e domosdoshme të parashtrorë propozim program të vet për punë dhe zhvillim të institucionit për periudhën prej katër vjet.

2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

3. Shpallja publike do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

4. Kandidatët i parashtrorin dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues i Muzeut lokal Galeria Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të Muzeut Galeria Kavadar në afat prej 5 ditëve pas përfundimit të shpalljes parashtron propozim deri te Kryetari i Komunës me arsyetim për zgjedhje të drejtorit.

Kryetari i Komunës në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev

Në bazë të Vendimit për publikim të Shpalljes publike për zgjedhje të Drejtorit të NP "Komunalec" Kavadar nr. 09-92/1 të datës 09.01.2018, ndërsa në pajtim me nenin 19-a paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16), Kryetari i Komunës së Kavadarit, publikon

**SHPLLJE PUBLIKE**

**Për zgjedhje të Drejtorit të NP "Komunalec" Kavadar**

Në bazë të nenit 23 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16),

Për drejtor mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

- ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit

- në momentin e emërimit me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune.

-posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë.

- ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Krahas dokumentacionit nga pika 1, kandidatët e interesuar duhet të parashtrorin edhe Program për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes së NP "Komunalec" Kavadar.

Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Dokumentet e arritura i shqyrton Komisioni i tre anëtarësh i zgjedhur nga Kryetari i Komunës në afat prej 8 (tetë) ditëve dhe pas kalimit të Shpalljes tërë dokumentacionin e parashtron deri te Kryetari i Komunës, i cili në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve sjellë Vendim për zgjedhje.

Lajmërimi për zgjedhjen e realizuar deri te kandidatët do të dorëzohet në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e parashtrimit të Vendimit për zgjedhje.

Kryetari i Komunës do të mbajë të drejtën që kandidatët me fletëparaqitje në gjendje të rregullt t'i intervistojë.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrorët deri në Arkivin e Komunës së Kavadarit (me shenjë: "Për Shpallje") në adresën në vijim: Sheshi "Marshall Tito" pn Kavadar.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev



Në bazë të nenit 30 dhe nenit 37 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12 dhe 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002), Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" – Kavadar

1. Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Drejtorit të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" – Kavadar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të ketë të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror (nga sfera e kulturës dhe veprimtarive shoqërore) të përcaktuar me statutin e institucionit;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në sferën e kulturës.
- posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë.
- Kandidati për drejtor është e domosdoshme të parashtrojë propozim program të vet për punë dhe zhvillim të institucionit për periudhën prej katër vjet .
- 2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrojë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.
- 3. Shpallja publike do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
- 4. Kandidatët i parashtrojnë dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov Klime" – Kavadar në rr. 7 shtator nr. 1 Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov Klime" Kavadar dhe në afat prej 5 ditëve pas përfundimit të shpalljes parashtron propozim deri te Kryetari i Komunës me arsyetim për zgjedhje të drejtorit.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev

Në bazë të nenit 20-g , ndërsa në lidhje me nenin 22 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për punësim në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2014 dhe 199/2014), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie e punës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 74/2015-teksti i pastruar) dhe Pajtimin nr. 18-14198/3 të datës 29.12.2017 nga Ministria e financave dhe Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në Institucionin publik komunal për fëmijë çerdhja për fëmijë Boris Trajkovski – Demir Kapi, Drejtori i IPKÇF "Boris Trajkovski" – Demir Kapi, publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE

#### PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR

Publikohet shpallje për plotësim të vendeve të lira të punës për kohë të caktuar prej më 01.01.2018 deri më 28.02.2018 për vendin e punës në vijim:

1. Ndhimës gjellëbërës – 1 (një) realizues
  - Shkalla e arsimit – arsim fillor me provim të dhënë profesional për gjellëbërës ose arsim të mesëm – shkalla III drejtimi hotelierik-turistik – gjellëbërës
  - Me ose pa përvojë pune

Orari javor i punës për vendin e punës (ndihmës gjellëbërës) është 40 orë, të ndara në 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë në ditën e premte prej ora 05:00 deri në ora 13:00. Neto pagesa mujore 12.000,00 denarë.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me aktin për sistematizim të vendeve të punës.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim.

- Dëshmi për arsim të mbaruar
  - Certifikatë të shtetësisë
  - Vërtetim/certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
  - Vërtetim/certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
- Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e ardhshme e ditës së publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën në vijim IPKÇF "Boris Trajkovski" – Demir Kapi, rr. "Marshall Tito" nr. 11.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrohen në afatin e caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat do të përmbajnë dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara dhe nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF "Boris Trajkovski" – Demir Kapi  
Drejtor  
Natalija Dimitrieva

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për bibliotekat (Gazeta Zyrtare e RM nr. 2004, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15, 39/16) dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002), Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon,

### SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar

1. Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Drejtorit të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të ketë të mbaruar arsim sipëror nga sfera e Shkencave shoqërore.
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari.
- posedon kompetenca për punë organizative dhe menaxhim me resurset njerëzore.
- posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë.
- Kandidati për drejtor është e domosdoshme të parashtrojë propozim program të vet për punë dhe zhvillim të institucionit për periudhën prej katër vjet.
- 2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrojë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.
- 3. Shpallja publike do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
- 4. Kandidatët i parashtrojnë dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar dhe në afat prej 5 ditëve pas përfundimit të shpalljes parashtron propozim deri te Kryetari i Komunës me arsyetim për zgjedhje të drejtorit.

Kryetari i komunës në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev

REPUBLIKA E MAQEDONISË  
Shkolla e mesme komunale  
Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" Strugë  
Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune dhe nenit 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik SHMK Gjmnazi "Dr. Ibrahim Temo" Strugë publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE nr. 1/2018

Për plotësim të vendeve të punës për kohë të caktuar punë më së voni deri më 31.08.2018

1. SHMK Gjmnazi "Dr. Ibrahim Temo" Strugë ka nevojë për punësime me kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018:

Nr. rendor	Shifra	Emërtimi i vendit të punës	Nr. i kryesve
1	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës italiane 12 ore mësimore	1
2	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës frënge – 9 orë mësimore deri ne kthimin e punëtorit nga pushimi mjekësor	1
3	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës maqedone – me vend jo të plotë pune 12 orë mësimore	1
4	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i matematikës orar jo të plotë 10 orë mësimore	1
5	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i psikologjisë orar jo i plotë 4 orë mësimore	1
6	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i historisë 18 ore mësimore- të lirura nga emërimi i ndihmës drejtorit deri ne kthimin e tij	1
7	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës angleze 18 ore mësimore	1
8	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës ruse 6 orë mësimore	1
9	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i fizikës 6 orë mësimore	1

Për mësim në gjuhën shqipe

1	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës shqipe 8 ore mësimore	1
2	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës shqipe ore të lirura na përgjegjësi i emëruar me orar jo të plotë pune 10 ore mësimore	1
3	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe me orar të plotë – ore të lirura nga punëtor që shfrytëzon pushimin e lindjes – deri ne kthim të tij	1
4	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i filozofisë, logjikës, etikë me orar jo të plotë orë	1
5	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës gjermane 12 ore mësimore	
6	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i matematikës 10 ore mësimore – ore të lirura nga emërimi i ndihmës drejtorit	
7	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i sociologjisë 9 orë mësimore	1
8	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjeografisë orar jo i plotë 10 orë mësimore	1
9	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i hyrjes në të drejtën orar jo i plotë 8 orë mësimore	1
10	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i pedagogjisë orar jo i plotë 6 orë mësimore	1
11	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i psikologjisë orar jo i plotë 6 orë mësimore	1
12	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës italiane orar jo i plotë 9 orë mësimore	1
13	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i lëndëve ekonomike orar jo i plotë 10 orë mësimore	1
14	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës frënge 10 ore mësimore ore të lirura nga drejtori i emëruar	1
15	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjuhës latine me orar të plotë.	1

Për mësim në gjuhën turke

1	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i matematikës orar jo të plotë 12 orë mësimore	1
2	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i fizikës orar jo të plotë 9 orë mësimore	1
3	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i lëndëve ekonomike orar jo të plotë 5 orë mësimore	1
4	OBN 03 02 303 001	Arsimtar i gjeografisë orar jo të plotë 6 orë mësimore	1

SHMK Gjmnazi Dr.Ibrahim Temo-Strugë

# ARKEOLOGËT ZBULOJNË NË IZRAEL "PARAJSEN" E KOHËS SË GURIT

Parajsë e jashtëzakonshme e kohës së gurit, është cilësuar zbulimi arkeologjik në afërsi të njërës prej rrugëve më të ngarkuara në Izrael. Lokaliteti parahistorik i ruajtur mirë, sipas rezultateve të ekspertëve, është shfrytëzuar nga gjuetarët e kohës së gurit, para gjysmë milion vjetësh, e që kanë lënë pas dëshmi qindra sèpata të dorës, shkruan "The Guardian", transmeton "Koha Ditore".

Gjetja në një thellësi prej pesë metrash në Jaljulia, në afërsi të qytetit Kfar Saba, sugjeron që një specie e zhdukur e njerëzimit të hershëm - homo erectus - mund të ishte

kthyer vazhdimisht në këtë lokalitet, mbase të tërhequr nga burimet e ujit dhe lojërat e bollshme, dhe ka lënë pas dëshmi mjete primitive pune të punuara në gur. Arkeologët besojnë që ky lokalitet në verilindje të Tel-Avivit ishte konsideruar si "parajsë" për tubimet e gjuetarëve parahistorikë - me një lumë, bimësi dhe bollëk të kafshëve që i inkurajonin ata të ktheheshin aty vazhdimisht. Zona e zgjeruar e lokalitetit ishte zbuluar në muajt e fundit, në një gërmim të përbashkët që e kanë bërë Autoritetet e Antikitetit të Izraelit në bashkëpunim me Departamentin e

Arkeologët besojnë që ky lokalitet në verilindje të Tel-Avivit ishte konsideruar si "parajsë" për tubimet e gjuetarëve parahistorikë - me një lumë, bimësi dhe bollëk të kafshëve që i inkurajonin ata të ktheheshin aty vazhdimisht

Arkeologjisë të Universitetit të Tel-Avivit. Gjetja më befusuese ishin dëshmitë e një industrie të zhvilluar mirë - duke iu referuar mjeteve të punës prej guri - e që përfshinte qindra sèpata dore të kulturës antike "acheulian" që kishte ekzistuar në periudhën e hershme të paleolitit, 1.5 milionë deri në 200 mijë vite më parë

## Edhe një çmim për Kadarenë



Shkrimtari Ismail Kadare merr një tjetër çmim, kësaj radhe në Itali. Në Udineze, Kadare u vlerësua me motivacionin si rapsod i dashuruar, por dhe kritik i popullit të tij. Kadare është fituesi i çmimit prestigjioz Nonino për vitin 2018, edicioni i 43 i këtij evenimenti që promovohet nga distilleritë e Perkotos në Udineze dhe që i shkon personazheve të mëdhenj të kulturës me gjykimin e një jurie të drejtuar nga nobelisti V.S. Naipaul. "Një rapsod i dashuruar, por edhe kritik me popullin e tij. Mes realitetit historik dhe legjendave që rikujtojnë madhësitë dhe tragjeditë e të shkuarës ballkanike dhe osmane, Kadare krijoi tregime të mëdha", shkruhet në vlerësimin e jurisë. Shkrimtari shqiptar merr kështu vlerësimin e radhës që i shtohet vargut të gjatë të vlerësimeve ndërkombëtare për të. Juria në Udineze gjithashtu vlerësoi me çmimin 'një mjeshtër i kohës sonë' filozofin italian Giorgio Agamben, krijuesi i konceptit Homo Sacer, qenia njerëzore për të cilin jeta është e shenjtë. Ceremonia e dhënies së çmimeve do të zhvillohet në distilleritë Nonino Di Ronchi në Perkoto, në Udineze, më 27 janar.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005), nenit 80 dhe nenit 82, pika 1, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 103/2008), pas marrjes së Pëlqimit për financim të vjetër nga Ministria e arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë nr. 12-10989/3 të datës 05.12.2017, Shkolla fillore komunale "Josip Broz Tito" Vallandovë, publikon:

### SHPALLJE

#### Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2017/18

Kuadri mësimor për mësimin në gjuhën maqedonase:

- Mësimdhënës të gjuhës frënge me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë)
- Mësimdhënës të etikës me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë dhe SHP Pirava)
- Mësimdhënës të etikës së religjioneve me 8 orë mësimore, 16 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë dhe SHP Pirava)
- Mësimdhënës të arsimit qytetar me 2 orë mësimore, 4 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Pirava)
- Mësimdhënës të shkencave natyrore me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Pirava dhe SHP Brajkovci)
- Mësimdhënës të artit figurativ me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Pirava)
- Mësimdhënës të inovacioneve me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë dhe SHP Pirava)
- Mësimdhënës të biologjisë me 12 orë mësimore, 24 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë)
- Mësimdhënës të shkencave natyrore me 8 orë mësimore, 16 orë punë - 1 (një) realizues (Vallandovë)
- Mësimdhënës të arsimit qytetar me 6 orë mësimore (Vallandovë)
- Mësimdhënës të mësimit klasor me 20 orë mësimore, 40 orë punë, 1 (një) realizues (Vallandovë)

Kuadri mësimor për mësimin në gjuhën turke:

- Mësimdhënës të gjuhës frënge me 8 orë mësimore, 16 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të gjuhës angleze me 15 orë mësimore, 30 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të gjuhës angleze me 6 orë mësimore, 12 orë punë - 1 (një) realizues (ПУ Дедели)
- Mësimdhënës të biologjisë me 6 orë mësimore, 12 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të kimisë me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të shkencave natyrore me 2 orë mësimore, 4 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të etikës me 1 orë mësimore, 2 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të njohjeve me religjionet me 2 orë mësimore, 4 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të artit figurativ me 4 orë mësimore, 8 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të informatikës me 5 orë mësimore, 10 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Çallakli)
- Mësimdhënës të arsimit teknik me 2 orë mësimore, 4 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Kazindoll)
- Mësimdhënës të inovacioneve me 1 orë mësimore, 2 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Kazindoll)
- Mësimdhënës të shkencave natyrore me 2 orë mësimore, 4 orë punë - 1 (një) realizues (SHP Kazindoll)

Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime, ndërrimi i parë është prej ora 7:30 deri në ora 13:30, ndërrimi i dytë është prej ora 12:30 deri në ora 18:30, në pajtim me orarin e orëve.

Krahas kushteve të përgjithshme të cilat i parasheh LMP, kandidatët për mësimdhënës duhet të përmbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim fillor, neni 77 dhe neni 80. Për orët për mësimin në gjuhën turke, kandidatët duhet të posedojnë dokument për njohje të gjuhës turke të dhënë nga institucioni për arsim sipëror qeveritar.

Vendet e punës janë për kohë të caktuar, deri më 31 gusht të vitit 2018;

Neto pagesa mujore është 20.640,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës për orar të plotë të punës;

Së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të parashetrojnë:

- Fletëparaqitje, të shkruar me dorë dhe e nënshkruar;
- Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar përkatës (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
- Vërtetim se nuk është i dënuar;
- Vërtetim se nuk është shqiptuar sanksion, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Fletëparaqitjet dhe dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen personalisht në arkivin e Shkollës fillore komunale "Josip Broz Tito" Vallandovë, në rr. "6-ti Noemvri" pb, Vallandovë deri në ora 14.

SHFK "Josip Broz Tito" Vallandovë  
Drejtor  
Daniella Xhonova

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr.167/2015), neni 59 dhe 60 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e RM nr.44/1995 deri 67/2017), Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës dhe miratimi nr.12-14687/2 nga data 11.12.2017 të MASH-Shkup dhe Vendimi i drejtorit të SHMK "Jovçe Tesliçkov"Veles, publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për punësim për kohë të caktuar deri më 31.08.2018

1. Mësimdhënës të lëndëve ekonomike, 20 orë mësimore, 40 orë në javë, 1 (një) realizues, orë të drejtorit, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë.

2. Mësimdhënës të sociologjisë, 8 orë mësimore, 16 orë në javë, 1 (një) realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 8.612,00 denarë.

3. Mësimdhënës të lëndëve ekonomike, 20 orë mësimore, 40 orë në javë, 1 (një) realizues, orë të personit deputet në Kuvendin e RM, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë

Shpallja zgjatë 5(pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të bëhet në afat deri në 45 ditë pas skadimit të afatit për aplikim.

Kandidatët duhet të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, ta njohin gjuhën letrare dhe alfabetin me të cilin e mbajnë mësimin,

**Dokumentet e nevojshme:**

-Fletëparaqitje-CV me biografi profesionale,

-Për vendin e punës mësimdhënës-diplomë për arsim të kryer shkalla VII/1 (original apo kopje e notuarizuar),

-Certifikatë për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike të kryer në institucione të akredituara të arsimit të lartë,

-Certifikatë të shtetësisë të R.Maqedonisë.

Dokumentet jo të kompletuara nuk do të merren parasysh.

**Dokumentet e kompletuara të dorëzohen në adresën: SHMK "Jovçe Tesliçkov"Veles, rr.Kukushka nr.37 Tel. 043/231 098**

I nr. 1958/2016

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori Hallik Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. "Sv. Kiril i Metod" nr. 54, bazuar në dokumentin për përmbarim Akti notarial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përmbarim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhliut Ardijan Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbarese të regjistruar në nr. 1958/2016 të datës 09.01.2018:

#### FTON

1. Borxhliu Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë, për shkak të dorëzimit të: - Procesverbal për shpjtje të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 175 paragrafi 3 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.12.2017 të Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari

-Konkluzion për Shpjtjen e dytë publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 04.01.2018 të Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

2. Personin Zhivka Ançevska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të: - Procesverbal për shpjtje të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 175 paragrafi 3 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.12.2017.

-Lajmërim nga 04.01.2018,

-Konkluzion për Shpjtjen e dytë publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 04.01.2018 të gjitha të Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHEN borxhliu Ardijan Ramadani, debitori i pengut Qemal Ramadani dhe personi Zhivka Ançevska se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.

Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E DYTË.

Përmbarusit  
Aleksandar Kuzmanovski

FC SHKUPI SJELL PËRFORCIMIN E DYTË

# SUPER-TALENTI BROJA VISHET BARDHEKALTËR

Broja që tani më është i Shkupit, pas vete ka edhe përvojën evropiane, duke luajtur në kampionatin belg, me ekipet e SK Deninze dhe ish-kampion belg, KAA Gent. Te ish-kampioni i trefishtë broja vjen nga radhët e Trepça '89, ndërsa është edhe kapiten i përfaqësueses kosovare U21

Shkup, 10 janar - Skuadra e FC Shkupi dje ka arritur të bëjë edhe blerjen e dytë të afatit kalimtar, duke sjellë në kampin bardhekaltër talentin më të madh në rajon, por që është vlerësuar edhe ndër më të dalluarit në Evropë, pasi shumë ekipe ishin vënë pas shërbimeve të tij. Bëhet fjalë për talentin nga Kosova, 21 vjeçar Rron Broja i cili tani më pas vete ka edhe një titull kampion me skuadrën e Trepça '89, ku edhe ka luajtur sezonin që kaloi. Broja është një nga mesfushorët më të talentuar dhe kapiten i përfaqësueses kosovare U21, ndërsa me Trepçën ai kishte edhe paraqitje në ndeshjet në kuadër të Ligës së Kampionëve. Ndërkohë, pas arritjes së marrëveshjes me FC Shkupi, Broja është shprehur i lumtur për arritjen e marrëveshjes me ish-

kampionin e trefishtë të Maqedonisë. "Padyshim se jam shumë i lumtur do të jem pjesë e klubit më të suksesshëm shqiptarë nga Maqedonia. Kisha dëgjuar qysh si fëmijë kur Shkupi ka luajtur me emër tjetër që është kampion i trefishtë dhe fitues i tri titujve të kupës. Andaj pa hezitim bëra zgjedhjen e duhur që të vesh fanellën e një skuadre kampione. Gjithsesi do të jetë për mua shumë me rëndësi që do të luajë edhe para një armate të madhe të tifozerisë shkupjane 'Shvercerat', dhe besoj se do së bashku me ekipin do arrijmë shumë suksese", ka thënë super talenti 21 vjeçar përfaqen e klubit. Ndryshe, Broja që tani më është i Shkupit, pas vete ka edhe përvojën evropiane, duke luajtur në kampionatin belg, me ekipet e SK Deninze dhe ish-

Padyshim se jam shumë i lumtur do të jem pjesë e klubit më të suksesshëm shqiptarë nga Maqedonia. Kisha dëgjuar qysh si fëmijë kur Shkupi ka luajtur me emër tjetër që është kampion i trefishtë dhe fitues i tri titujve të kupës. Andaj pa hezitim bëra zgjedhjen e duhur që të vesh fanellën e një skuadre kampione. Gjithsesi do të jetë për mua shumë me rëndësi që do të luajë edhe para një armate të madhe të tifozerisë shkupjane 'Shvercerat'



## Kaçe pranë firmës me Panatinaikosin

Me sa duket do të marrë fund në mënyrë pozitive për Ergys Kaçen telenovela e merkatos në këto ditë të para të janarit sa i përket transferimit të mesfushorit shqiptar të klubi i Panatinaikos. I lënë në harresë te PAOK ku nuk ka hapësira aktivizimi për të, mesfushori është shumë pranë kalimit te një klub i cili është shpallur 20 herë kampion në Greqi, por aktualisht po kalon një krizë financiare. Kaçe është pjesë e marrëveshjes mes dy klubeve për kalimin e Moludo nga Panatinaikos te PAOK. Mbrojtësi brazilian do të huazohet deri në fund të sezonit te PAOK dhe në këmbim Panathinaikos do të marrë 500 mijë euro, si dhe Kaçen e Konstandinidis. Lojtarët do të jenë në huazim deri në verë, me të drejtë blerjen e tyre përfundimtare. Kjo është zgjidhja ideale për mesfushorin shqiptar, i cili nuk luan rregullisht prej kohësh dhe është zhdukur nga fusha e lojës, edhe pse deri dy vite më parë cilësohej si një nga talentet më të mëdhenj të prodhuar nga kampionati grek në vitet e fundit.

QATIP OSMANI FLET PËR PËRGATITJET DHE SEZONIN PRANVEROR

## Asgjë s'ka përfunduar, në lojë janë edhe 54 pikë

Shkup, 10 janar - Futbollistët e Shkëndijës nën udhëheqjen e trajnerit Qatip Osmani, kanë vazhduar edhe gjatë ditës së djeshme përgatitjet në Ohër, ndërsa këtu do të qëndrojnë deri më 16-të janar. "Nga dita e martë jemi në Ohër, ndërsa dje filluam me nga dy stërvitje në ditë. Gjithashtu do të zhvillojmë edhe dy ndeshje në Ohër, por kjo varet nga ajo se a do të ketë edhe skuadra tjera derisa ne jemi në përgatitje", shpreh për "gol.mk" Osmani. Ndryshe, në fillim të përgatitjeve dimërore, kuqezinjtë prezantuan Mevlan Adilin, Seladin Mustafin dhe Sabit Bilalin si futbollist të ri, ndërsa stafi teknik nuk e përjashton mundësinë që ekipi të përforcohet edhe me një futbollist të dëshmuar. "Përforcimi i vër-



tetë është Mevlan Adili, i cili erdhi nga skuadra e UTA Arad nga Rumania. Dy të tjerët të cilët i sollëm

janë të rinj dhe me perspektivë, të cilët do të duhet të dëshmojnë në stërvitje. Realisht nuk kemi nevojë

për futbollist të ri, por nëse vendosim të blejmë ndonjë, ai duhet të jetë i dëshmuar dhe futbollist kua-

litativ", shtoi më tej Osmani, i cili e lëshon topin për toke kur është fjala për epërsinë që ka kundrejt Vardarit dhe ekipin e përgatitjet sikurse mos të ketë tetë pikë epërsi. "Shumëherë kemi qenë dëshmitar të përmbysjeve, për at arsye nuk duam ta gënjejmë vetveten se gjithçka ka përfunduar. Në pjesën e dytë të sezonit ka edhe 18-të ndeshje dhe në lojë janë 54 pikë, që donë të thotë se asgjë nuk ka përfunduar", përfundoi trajneri i KF Shkëndija. Kujtojmë, pas përfundimit të fazës së dytë në Ohër, kuqezinjtë do të rikthehen në Tetovë ku do të stërvitet deri më 20 janar, ndërsa më pas pasojnë përgatitjet finale në Antalia, ku tetovarët do të zhvillojnë edhe katër ndeshje kontrolluese.


**KRYETARI I KOMUNËS - ГРАДОНАЧАЛНИК**

Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5 | Бул. Христијан Т. Карпош бр. 5  
Tel: 02/2616-860 | faks: 02/2616-867  
info@cair.gov.mk | www.cair.gov.mk  
Nr. / \_\_\_\_\_ prej

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e R.M.-së" nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015 dhe 39/2016) dhe, në përputhje me Vendimin për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e Drejtorit të NP „Shkupi i Vjetër" - Shkup nr.të datës 09.01.2018, Kryetari i Komunës së Čairit, shpallë:

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**për zgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes publike „Shkupi i Vjetër – Shkup**

1. Kandidatët për zgjedhjen drejtor duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jetë nënshtruar i Republikës së Maqedonisë,
  - të ketë më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkollën VII/1 të arsimit të lartë,
  - në momentin e zgjedhjes të mos i jetë shqiptuar me vendim gjyqësor të formës së prerë gjohë ose sanksion për shkelje, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
  - të ketë minimum 5 vjet eksperiencë pune,
  - të ketë një nga Certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtare ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) - më së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) - më së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) - më së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) – të përfunduar ose BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë, i
2. Kandidatët për drejtor përveç dëshmi për plotësimin e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
  - Dëshmi për stazhin e punës
  - Propozim – Program për punën dhe zhvillimin e ndërmarrjes
3. Dokumentacionin e duhur kandidatët janë të detyruar ti dorëzojnë në origjinal ose kopje të verifikuar te noteri.
4. Afati i dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm është 8 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
5. Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te Arkivi i Komunës së Čairit– me shënimin Kryetari i Komunës së Čairit, “Për konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit të NP „Shkupi i Vjetër” – Shkup.
6. Drejtori zgjidhet me mandat 4 vjeçar.
7. Njoftimi për zgjedhjen e realizuar deri te kandidatët do të bëhet me shkrim pas sjelljes së Vendimit për zgjedhje.
8. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe i pa kompletuar nuk do të shqyrtohet.

përpiloi / - kontrollloi /-A.S

Kryetar  
Visar Ganiu

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e RM –së“ nr. 27/2014), neni 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e RM –së“ nr. 145/2014 - teksti i spastruar) dhe neni 82 i Ligjit për arsim fillor (“Gazeta zyrtare e RM-së“nr. 103/08, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017), me Pëlqim të MASH nr. 12-11042/2 të dt. 07. 12. 2017, U.d. drejtor i SHFK “Nuri Mazari “ Dollogozhdë publikon :

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për plotësimin e vendeve të lira të punës , në kohë të caktuar deri më 31. 08. 2018, financim i vjetër për vitin shkollor 2017/2018 me mësim në gjuhën shqipe**

1. Një arsimtarë për Shkenca natyrore me fond të plotë orësh dhe me kohë të caktuar .
2. Një arsimtar për Histori me fond jo të plotë orësh për 10 orë mësimore me kohë të caktuar .
3. Një arsimtarë për Etikë me fond jo të plotë orësh për 6 orë mësimore .
4. Një arsimtarë për Njohja me religionin me fond jo të plotë orësh për 4 orë mësimore .

Kushtet : Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ,si dhe kushtet e veçanta nga neni 80 të Ligjit për arsim fillor.

**Kandidatët e interesuar së bashku me kërkesën duhet t'i kompletojnë këto dokumente :**

- Diplomë për shkollimin e kryer
- certifikatë të shtetësisë
- certifikatën për provimin e dhënë profesional
- certifikata e mjekut (pas pranimit) .

Të interesuarit dokumentet duhet t'i dërgojnë te sekretari i shkollës . Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim . Shpallja do të jetë e hapur 5 ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor dhe Agjencinë për punësim.

SHFK “Nuri Mazari “ Dollogozhdë  
U.d. Drejtor,  
Argëtim Seferi

**Republika e Maqedonisë**  
**Ministria e Mjedisit Jetësor**  
**dhe Planifikimit Hapësinor**

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

**PUBLIKON**

Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzim të ujit nga akumulimi “Globočica” për kultivimin e peshqve

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujëra (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15, dhe 52/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është parashtruar Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzim të ujit për kultivim të peshqve në akumulimin artificial “Globočica” me numër UPI-11/5-966/2017 të parashtruar më datë 29.06.2017.

Parashtrues i kërkesës:  
“Sharan 2012” SHPKNJ  
r. “Abas Fmin” nr. 210A  
Ohër

Objektet e zëna, ferma në formë kafazi, e vendosur në ujërat e akumulimit “Globočica” janë të definuar me koordinatat në vijim:

Koordinatat e pikave	
1.	7470584,02 4574277,77
2.	7470599,74 4574277,77
3.	7470599,74 4574304,71
4.	7470584,02 4574304,71

Informacione në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail [n.pavlovska@moepp.gov.mk](mailto:n.pavlovska@moepp.gov.mk).  
Opinionin i përfshirë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtrtojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardit “Goce Dellçev” nr. 18, ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.


**Republika e Maqedonisë**  
**Ministria e Mjedisit Jetësor**  
**dhe Planifikimit Hapësinor**


MKC EN ISO 9001:2009

Republika e Maqedonisë  
**Ministria e Mjedisit**  
**Jetësor**  
**dhe Planifikimit**  
**Hapësinor**

Bul.“Goce Dellçev” nr.18,  
1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë  
Tel. (02) 3251 400  
Faksi. (02) 3220 165  
E-mail:  
[infoeko@moepp.gov.mk](mailto:infoeko@moepp.gov.mk)  
Ueb faqja: [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)

Në bazë të nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015 dhe 39/2016), dhe nenit 4 të Rregullores për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përpunimit të raportit për adekuatshmërinë e studimit për vlerësimin e ndikimit të projektit ndaj mjedisit jetësor (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 33/06), njoftohet publiku se Komisioni për përpunimin e raportit për adekuatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor për projektin: “Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza për komunën e Velesit”, përgatiti një

**RAPORT**

për adekuatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor për projektin: “Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza për komunën e Velesit”,

1. **Investuesi** : Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
Selia: bul. “Goce Dellçev” nr.18, Shkup  
Personi për kontakt : Jadranka Ivanova,  
E-mail: [j.ivanova@moepp.gov.mk](mailto:j.ivanova@moepp.gov.mk)
2. **Shtëpia konsultuese** e cila e përgatiti Studimin e Vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor : “SAFEGE” në konsorcium me NIRAS, AECOM dhe SAFEGE SHPKNJ  
Personi për kontakt : Kristina Petrovska, ksperte për VNMJ  
E-mail: [kristinapetrovska12@gmail.com](mailto:kristinapetrovska12@gmail.com)
3. **Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar**  
Me këtë projekt planifikohet rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të grumbullimit dhe kanalizimit dhe ndërtimit të një stacioni për trajtimin e ujërave të zeza për aglomeratin e Velesi. Qëllimi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës komunale për grumbullimin e ujërave të zeza në rajonin e Velesit. Zona e projektit mbulon rreth 49 900 banorë dhe përfshin këto vendbanime: Qytetin e Velesit, Gorno Orizani, Prevelacin, Bashino Selo dhe Chaloshëvën.
4. **Informacione shtesë** mund të merrni në Sektorin e Komunikimit me Publikun rr. “Kej Dimitar Vllahov” nr.4 tel. 3 251 449 dhe Drejtoria e Mjedisit Jetësor ndërtesa e TVM bul. Goce Dellçev pn. Tel 3 251 462 pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)


**Republika e Maqedonisë**  
**Ministria e Mjedisit Jetësor**  
**dhe Planifikimit Hapësinor**


MKC EN ISO 9001:2009

Republika e Maqedonisë  
**Ministria e Mjedisit**  
**Jetësor**  
**dhe Planifikimit**  
**Hapësinor**

Bul.“Goce Dellçev” nr.18,  
1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë  
Tel. (02) 3251 400  
Faksi. (02) 3220 165  
E-mail:  
[infoeko@moepp.gov.mk](mailto:infoeko@moepp.gov.mk)  
Ueb faqja: [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)

Në bazë të nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015 dhe 39/2016), dhe nenit 4 të Rregullores për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përpunimit të raportit për adekuatshmërinë e studimit për vlerësimin e ndikimit të projektit ndaj mjedisit jetësor (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 33/06), njoftohet publiku se Komisioni për përpunimin e raportit për adekuatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor për projektin: “Grumbullimi dhe trajtimin e ujërave të zeza për komunën e Shtipit”, përgatiti një

**RAPORT**

për adekuatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor për projektin: “Grumbullimi dhe trajtimin e ujërave të zeza për komunën e Shtipit”,

1. **Investuesi** : Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
Selia: bul. “Goce Dellçev” nr.18, Shkup  
Personi për kontakt : Jadranka Ivanova,  
E-mail: [j.ivanova@moepp.gov.mk](mailto:j.ivanova@moepp.gov.mk)
2. **Shtëpia konsultuese** e cila e përgatiti Studimin e Vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor : “SAFEGE” në konsorcium me NIRAS, AECOM dhe SAFEGE SHPKNJ  
Personi për kontakt : Fana Hristovska , ekspert për VNMJ  
E-mail: [fhristovska@yahoo.com](mailto:fhristovska@yahoo.com)
3. **Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar:**  
Me këtë projekt investitori parashikon ndërtimin e stacionit për trajtimin e ujërave të zeza. Lokacionin për ndërtimin e stacionit për trajtimin e ujërave të zeza është në vendin e quajtur “Kalimerovë” në komunën e Shtipit. Kapaciteti i planifikuar i SPUZ është rreth 53 700 EB. Sipërfaqja e përgjithshme e parashikuar për ndërtim është 3,7 ha.
4. **Informacione shtesë** mund të merrni në Sektorin e Komunikimit me Publikun rr. “Kej Dimitar Vllahov” nr.4 tel. 3 251 449 dhe Drejtoria e Mjedisit Jetësor ndërtesa e TVM bul. Goce Dellçev pn. Tel 3 251 462 pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk).

Shkolla e mesme komunale

“Krstë P. Misirkov”  
Nr. 04-20/1  
10.01.2018  
Demir Hisar

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 145/2014 tekst i pastruar), dhe nenit 92 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 153/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), dhe nenit 14 të Ligjit për emërim dhe plotësim të Ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 33/10), dhe nenit 101 të Statutit të shkollës, u.d drejtori pranë SHMK “Krstë P. Misirkov” Demir Hisar publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**

**Për punësim për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018**

1. Mësimdhënës të matematikës me 6 orë mësimore me neto pagesë prej 6.404,00 denarë;
2. Mësimdhënës të Biznesit me 4 orë mësimore me neto pagesë prej 4.200,00 denarë;
3. Mësimdhënës të Inovacioneve dhe sipërmarrësi me 4 orë mësimore me neto pagesë prej 4.200,00 denarë;
4. Mësimdhënës të Sportit dhe aktiviteteve sportive me 5 orë mësimore me neto pagesë prej 5.302,00 denarë;
5. Mësimdhënës të Mësimin praktik (drejtimi i pylltarisë) me 11 orë mësimore me neto pagesë prej 11.638,00 denarë;
6. Mësimdhënës të Gjuhës gjermane me 2 orë mësimore, deri në kthimin e punëtorit me neto pagesë prej 2.200,00 denarë;
7. Mësimdhënës të Artit të muzikës me 7 orë mësimore, deri në kthimin e punëtorit me neto pagesë prej 7.509,00 denarë.

1. Kandidatët të cilët do të paraqiten në Shpallje krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të përbushin kushtet nga Ligji për arsim të mesëm dhe normativin për kuadrin mësimor për arsim të mesëm të sjellë nga Byroja për arsim të R. Maqedonisë.
2. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendin e punës në lidhje me Shpalljen të jenë shtetas të R. Maqedonisë, do t'i nënshtrohen kontrollimit të njohjes së gjuhës letrare maqedonase në afat prej 5 /pesë/ ditëve pas kalimit të afatit për kohë të caktuar për parashtrim të fletëparaqitjeve.
3. Shpallja zgjatë 5 /pesë/ ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa afati n të cilin do të realizohet zgjedhja është 10 /dhjetë/ ditë pas kalimit të afatit për paraqitje sipas Shpalljes.
4. Lutja së bashku me dokumentet e nevojshme në lidhje me Shpalljen të parashtrohet në adresën: SHFK “Krstë P. Misirkov” rr. “Goce Dellçev” pn Demir Hisar personi për kontakt: Maja Llozanovska, tel. 047 276 431.
5. Orari i punës është në një ndërrim dhe zgjatë prej ora 07 deri në ora 14:30 në pajtim me orarin e orëve.
6. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

UD Drejtor  
Maja Llozanovska



# BARCELONA, KLUBI MË I VËSHTIRË DHE MË I KËRKUARI NË BOTË



Ish-mjeshtri i mesfushës së Barcelonës, Çavi, ka kritikuar stilin e lojës të Real Madridit. Xavi beson se Realit i mungon kultura e futbollit të bukur në "Bernabeu", duke reflektuar kohën e Murinjos nga viti 2010 deri në vitin 2013.

**N**deshjet e La Ligas dhe Ligës së Kampionëve u ndezën në sezonin e kaluar, por të besuarit e Zinedin Zidane kanë luftuar këtë mandat, tashmë 16 pikë pas liderëve të arratisur, Barcelona dhe Lionel Messi. Ish-mesfushori i Barcelonës, Çavi, beson se Real Madridi nuk ka kulturën e futbollit të bukur në "Santiago Bernabeu", duke theksuar kohën e Hoze Murinjos në krye të tij, më 2010-2013. "Barcelona është provimi përfundimtar për një lojtar", – tha Çavi, i cili tani luan për Al Sadd në Katar, teksa foli për "El País". "Është klubi

më i vështirë dhe më i kërkuari në botë. Real Madridi nuk luan kaq bukur, por në "Bernabeu", nëse një mbrojtës e mban topin në këmbë, është mirë. Real Madridi i Murinjos e godiste topin drejtpërdrejt, në pjesën e sipërme. Murinjo u tha lojtarëve të tij që kurrë të mos e ndalnin topin, për të luajtur shpejt dhe pastaj Angel Di Maria, Cristiano Ronaldo, ose Karim Benzema do të thyejnë. Ata nuk duan të luajnë futboll. Tani, shtatë lojtarë sulmojnë dhe Kasemiro qëndron prapa, për të mbuluar qendrën. Mesfushori i Barcelonës, Sergio Busquets, nuk

mund ta bëjë këtë, pasi nuk është i shpejtë si ai. Kasemiro është super i shpejtë, por ka probleme me gjithçka tjetër, pasi nuk ka punuar në to. Ai ka karakteristika të tjera, është më mbrojtës, mbulon më shumë terren, por nuk dominon hapësirën, nënvizoi më tej ai. Çavi ishte, gjithashtu, kritik ndaj aspektit individual të disa lojtarëve të Real Madridit, pasi u pyet për Iskon dhe Marko Asensio. "Këta të rinj duhet të dinë se çfarë më tha ish-trajneri i Spanjës, Luis Aragones. 'A doni të luani futboll të bukur, apo futboll të mirë?' Nuk dua të flas me emra, por në La Liga

ka shumë lojtarë që kanë impresionuar dhe më pas janë zhdukur pa gjurmë. Messi është simboli i futbollit të mirë dhe kaq të bukur". Në fund Çavi foli edhe për krahasimin mes Messit e Ronaldos, që për të në asnjë mënyrë nuk qëndron. "Taktikisht ai (Messi) kupton gjithçka. Është vërtet mëkat që ai po krahasohet me dikë tjetër. Messi është në dijeni të të gjithave – hapësirës, kohës, ku janë bashklojtarët e tij dhe kundërshtarët. Derisa, Ronaldo nuk mund të luaj në qendër të sulmit. Nuk i përshtatet atij", përfundoi ai.

## U riktheva për të shkuar në Botëror

Ky është viti i Botërorit të futbollit dhe të gjithë futbollistët kanë dëshirë të bëjnë një paraqitje të mirë në këtë eveniment. Madje ka nga ata që synojnë të shkojnë në Botërorin që zhvillohet në Rusi, siç është futbollisti argjentinas Karlos Tevez, që pas një viti në Kinë u rikthye të luajë në vendlindje me skuadrën e Boca Juniors. "E pranoj që të siguroj një vend në Botërorin e Rusisë do të ishte fantastike, sidomos për një futbollist të moshës time. Ndaj vendosa të luaj me Bokan, për të qenë pjesë e kombëtares. Kam edhe pak vite kohë për të luajtur futboll dhe do të përpiqem t'i shijoj ato, duke shpresuar të jem pjesë e kombëtares në Botërorin rus", tha Tevez pas mbërritjes në Argjentinë.



## Juventus mund ta fitojë Ligën e kampionëve



Këtë sezon, Sami Kedira është një nga shtyllat e mesfushës së Juventusit, teksa me besueshmëri dhe urtësi u shërben taktikave të Massimiliano Alegrit. I intervistuar nga "Sky", Kedira hedh shikimin e tij në pjesën e dytë të sezonit. "Ky edicion është i ndryshëm nga të tjerët, sepse në garën për kreun e Serie A ka kaq shumë ekipe të larta, Napoli sigurisht, por edhe Interi, Roma, Lacio, Juventus natyrisht, kështu që është edhe më e vështirë për ta fituar titullin. Ne kemi për të

punuar edhe më shumë, do të përpiqemi për ta fituar atë. Është e rëndësishme për të qëndruar të fokusuar, por unë mendoj se këtë vit do të jetë më e vështirë për ta përsëritur titullin", u shpreh Kedira, i cili foli edhe për Ligën e kampionëve. "Liga e Kampionëve? Në fazën e grupeve mund të paraqiten disa surpriza, si çdo vit, por turneu i vërtetë fillon në raundin e dytë. Nuk ka një favorit të vetëm. Është Bajern Munihu me trajnerin e ri, Mançester Siti apo PSZH, që kanë një pjesë të madhe lojtarësh ekonomikë dhe cilësorë në dispozicion; po ashtu Real Madridi, Barcelona, Juventus. Janë shumë ekipe, që mund ta fitojnë Ligën e Kampionëve", deklaroi njëri nga shtyllat e mesfushës së Juventusit. Cekim, Juventus aktualisht mban pozitën e dytë në Serie A, ndërsa me një pikë më shumë kampionatin e kryeson Napoli.

## Interi, një eksperiencë e shkëlqyer, por e vështirë

Në një intervistë të gjatë të dhënë për "Barcelona TV", ylli brazilian Filip Kutinjo, i porsa transferuar nga Liverpool te Barcelona për 160 milionë euro, ka folur edhe për eksperiencën e tij te Interi. Një aventurë që ka shënjuar karrierën e tij, duke qenë skuadra e parë në Evropë, por njëkohësisht e konsideruar edhe si një eksperiencë e dështuar, për minutazhin e reduktuar në dispozicion të brazilianit, dhe rendimentin jo në përputhje me pritshmëritë gjatë sezoneve 2012-2013. "Nisa të kuptoj faktin që po bëhesha futbollist profesionist, pikërisht ditën kur firmosa kontratën time të parë me një klub evropian, Inter, por isha shumë i ri, vetëm 16 vjeç. E shihja se si gjërat po bëheshin gjithmonë e më serioze, por ishte e vështirë për një djalosh që vinte nga një tjetër kulturë dhe që kishte lënë gjithçka. Zgjati dy vite, erdha me prindërit e mi dhe të fejuarën, që tashmë



është bërë bashkëshortja ime. Milano më dukej gjigante, klubi kishte shumë kampionë. Ishte një eksperiencë e shkëlqyer, por e vështirë. Sikur të kisha vajtur i vetëm,

atëherë do të kisha vdekur. Kisha nevojë për mbështetjen e të fejuarës time dhe të kisha pranë familjen", rrëfeu Kutinjo, për eksperiencën e tij zikaltër.



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Përfitoni nga yjet që janë në anën tuaj sot për të marrë në dorë një situatë të pasigurt sentimentale dhe të bëni gjithçka për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për marrëdhënien në çift! Nëse jeni vetëm dhe kërkoni aventura, kjo ditë ofron shumë mundësi për ju. Në aspektin profesional sot është një ditë e rëndësishme për të realizuar objektivat tuaja.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Një ditë e vështirë për jetën tuaj personale. Marrëdhënia juaj në çift mund të përjetojë momente kritike, dhe do ju duhet të punoni shumë për t'i dhënë zgjidhje. Prania e Hënës, Marsit dhe Jupiterit i jep mundësi beqarëve për të pritur momentin e duhur me qetësi dhe durim për të krijuar lidhje. Në punë është mirë të jeni i kujdesshëm.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Dita e sotme për çiftet Binjakë do të jetë rutinë dhe pa lajme të rëndësishme. Nëse gjatë kësaj periudhe ju ka munguar dashuria dhe vëmendja e partnerit/es, sigurohuni të gjeni pikën kyçe ku çalon lidhja. Beqarët do kenë njohje të reja dhe do të tërhiqen nga një person. Në punë mos bëni hapa të rrezikshëm.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Dita nuk do të jete qetë, edhe pse me Hënën në shenjën tuaj ju nuk mund të gjeni dot një ekuilibër. Ju gjithashtu jeni mjaft të shqetësuar gjatë kësaj periudhe, kështu bëni mirë ta distanconi pak veten nga dashuria. Për beqarët do të jetë një ditë e paharrueshme, takimet do të jenë spektakolare! Me Marsin në Shigjetar mund të përqendrohni te puna me perspektiva të reja.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Ditë fantastike nga shumë pikëpamje. Jeta emocionale ju favorizon në shumë gjëra sot, veçanërisht rimëkëmbjen e marrëdhënies në çift. Ata që janë vetëm do të hedhin hapa të shpejtë për të krijuar një lidhje. Në punë mund të fitoni pikë të reja dhe të merrni përsëri në dorë frenat e disa situatave që dukej sikur i kishit lënë mënjanë.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Ju do të keni shumë mundësi për të rifituar kontrollin e ndjenjave tuaja. Romantizmi do të jetë në nivelin më të mirë duke ju falur shumë emocione në çift. Beqarët sot do të jenë më shumë se kurrë e gatshëm për të përballuar seriozisht njohjet e reja. Perspektiva juaj dhe qartësia mendore në punë do ju ndihmojnë të kryeni projektet tuaja.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Sot për ju do të jetë një ditë e qetë, por jo pa surpriza dhe kuriozitet. Do të përjetoni një marrëdhënie të shkëlqyer, dashuria me partnerin/en është e thellë dhe kjo ju mbush me gëzim! Nëse jeni vetëm, do të duhet të punoni shumë për të bërë arritje të reja. Nëse keni probleme në punë, së shpejti do t'i zgjidhni ato. Fitoni besimin e atyre që duan të punojnë me ju.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Yjet bëjnë gjithçka për të mundësuar një ditë të shkëlqyer për ju. Sot edhe ata që janë në një histori dashurie do të përjetojnë momente gëzimi të cilat do ju falin vetëm lumturi. Nëse jeni vetëm do të duhet të mendoni për situatën tuaj. Hiqni të gjitha pasiguritë. Ju jeni shumë të kualifikuar në punë, por duhet të hiqni dorë nga negociatat e vështira.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

E mërkura nuk parashikohet një ditë favorizuese për ju. Shmangni ekzagjerimet me fjalët që mund të përdorni gjatë një diskutimi me partnerin/en tuaj dhe përpuni të mbani impulsivitetin përbrenda jush. Beqarët do të gjejnë sot kënaqësi në sport, aktiviteti fizik do t'ju bëjë mirë. Në punë do të bëni mirë të bashkëpunoni me kolegët tuaj.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Ndiqni imagjinatën tuaj dhe mos u kushtëzoni nga ndonjë situatë e pakëndshme që po përjetoni. Kjo gjë do të sjellë gëzim në marrëdhënien tuaj në çift. Beqarët do të jenë në gjendje të marrin stimuj të rinj nga një miqësi e re. Kreativiteti juaj në punë nuk do të mungojnë dhe yjet parashikojnë që do jeni shumë produktivë.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Me Hënën në kuadraturë rrezikoni të gaboni. Sot nuk do të jeni në gjendje të përqendrohni në konkretizimin e ndjenjave tuaja. Më mirë të prisni para se të merrni një vendim ju që jeni në çift. Beqarët do tregohen të hapur ndaj ftesave për takime. Stabiliteti juaj i fituar në punë do t'ju ndihmojë të rrisni të ardhurat.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Mundohuni të ruani qetësinë në jetën tuaj edhe nëse jeni duke përjetuar një histori dashurie të pakënaqshme. Ndoshta së shpejti çdo gjë ndryshon dhe lumturi do të kthehet! Emocione të bukura po vijnë edhe për beqarët, me hijeshinë tuaj do të bëni për vete shumë persona. Hëna e favorshme sot ju ndihmon të ndiheni më të përgatitur për t'u përballur me vështirësitë në punë.

Mensur Mamuti	SHIH FOTON	QYTET NË NORVEGJI	BROTHER	VRASESI I ESAT PASHË TOPTANIT, RUSTEMI	NDAJFOLJIE SASIE	LASHTËSIRA	FOTO MODELI, KEMPBELL	<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Shqipëria pas referendimit popullor shpallet Republika Popullore Socialiste</p> <p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">NE KETE DATE</p> <p style="text-align: center;">11 JANAR 1946</p>					
QYTET SHQIPTAR													
LUMTURIA ABSOLUTE SIPAS BUDIZMIT													
ZIEN					T.O. KREATORJA E MODËS, KOKO								
E.E.			KEMI QENE I FTOHURI, SHENDET-LIGU										
RENEWABLE HEAT INCENTIVE				PROVINCE NË JAPONI PËRSËRTJE E BRKQJEVE NË VARGJE									
PSEUDONIM I.E.H.							VEND TURISTIK NË GREQI						
VEZË E RRABHUR DHE E FERGUAR													
KËNGË E DOL-JETISHT LËNDË PLASESE													
<b>B</b>					T.P. GJENDJE PIKELLIMI							AKTORI AMERIKAN, ENTONI QYTET SHQIPTAR	<b>K</b>
KOHA	I MBYLLUR TEKN. E IBM PËR RUAJ. E TE DHËNAVE											VEPËR E.E.H.	
METËR		LIQEN Ë AM. VERIORE ANËTARI I SENATIT				PRODH ITAL. KOMP. JUTERËSH POHIM, ÇEK							
PHOTOSHOP			ANGSTREM REOMIR		KOMPANI KOZMETIKE QYTET ITALIAN					MBRETI I SHEKSPIRIT QYTET GREK			
USHTAR I PAGUAR								LLOJ SHTYPI SARAJEVA					
ANKONA			BANORE E IMOLAS NDREQËS LESASH								SHKO INTERNATIONAL RESOURCES GROUP		
VRAPIM I SHPEJTE I KALIT						TEMPO TON	VAJZA E BOTËS SE ÇUDIRAVE FRIKË E MADHE						
NGUSHTIMET E ENËVE NJËRI NGA MUSKETARËT								KIK BOKSERI HOLLANDEZ, PITER FLORIRI					
<b>A</b>				E LËSHOJ NOTË MUZIKORE				ME TË META DHANORE E NYJES SË PERP. "E"					
<b>T</b>						VARG CELZIUS						TRAJTË E SHKURTER E PEREM. VET. URAN	
PSEUDONIM I.E.H. TULLUZ LOTREK					VEND NË SHQIPËRI								REZE

ZGJIDHJET: ELBASAN, NIRVANA, VION, TO, EE, ISHIM, RH, AKI, HASANI, OMELETA, XHEMILES, BARUT, TP, K, I REZERVAR, GJ, M, IRI, OLIVETI, PS, A, AVON, LIR, MERCENAR, SITO, AN, IMOLASE, IK, GALOP, T, ALISA, STENOZAT, ARTS, ATOS, LE, MANGËT, TARASI, SERI, TË, RIRI, CËRRIKU, R

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

4								9									
		3	5				2			2	5		9		3	7	
2		1	7	9			3	6	3			6					9
	8		3			4		6		1	8		4		7	6	
6												8		7			
			9		5					7	3		1		2	4	
3			6	8	7		1	5	8			3					4
			2	4			6			4	9		5		8	1	
5								3									

Shumë i lehtë: 468231579, 793546218, 251798346, 985324761, 634187952, 127965834, 346879125, 812453697, 579612483, Mesatar: 796135482, 125498376, 384672159, 918243765, 452867931, 673519248, 867321594, 249756813, 531984627.

## Astronauti japonez është zgjatur 9 cm në hapësirë

Astronauti japonez i cili ka kaluar 3 javë në Stacionin Ndërkombëtar Hapësinor (ISS), njoftoi se është zgjatur rreth 9 centimetra. Sipas lajmit të BBC, astronauti Norishige Kanai, nga llogaria e tij në Twitter ka shkruar: "Mirëmëngjesi të gjithëve. Na është bërë matja e trupit për të parë ndryshimet pasi që kemi ardhur në hapësirë dhe gjatë kësaj kohe ashtu sikur një bimë jam zgjatur rreth 9 centimetra". "Jam i shqetësuar nëse do të më nxë karrigia e kapsulës kozmike Soyuz në muajin qershor kur do të kthehem në botë", u shpreh Kanai. Boshti kurrizor i njeriut mund të zgjatet dhe të zgjerohet për shkak të mungesës së presionit ndaj rruazave në mjedise pa gravitet.



## Këlyshi gjigant i Britanisë

Ju prezantojmë me këlyshin e qenit më të madh në Britani. Fluffy është vetëm 10 muajsh, por peshon 44 kg dhe është 1.6 metra i gjatë. Ka shumë mundësi që kur të rritet të bëhet sa një tigër i vogël, me një peshë 60-80 kg. Personat që po kujdesen aktualisht për këtë këlysh gjigant u kanë bërë thirrje njerëzve me "shumë hapësirë në zemër dhe në shtëpi" që ta adoptojnë këtë qen.

## "Monstra" rus, mbi 900 akuza për përdhunime!

Më shumë se 900 akuza për përdhunim dhe veprime seksuale me dhunë rëndojnë mbi një 37-vjeçar rus. Mediat ruse shkruajnë se Viktor Lishavsky abuzonte me 5 nxënëse nën 13 vjeç për të cilat ishte kujdestar ligjor, ndërsa i trajtonte si "skllave seksuale". "Monstra" rus është vënë në pranga gjatë qershorit të vitit të kaluar, por vetëm së fundmi janë zbuluar detaje të reja nga krimet e tij. Gjatë ditës, 37-vjeçari punonte në një dyqan këpucësh, ndërsa natën ai abuzonte sistematikisht me vajzat adoleshente për një periudhë gati 5-vjeçare, thuhet në raport.



## 33 vjeçarja sjell në jetë fëmijën e vëllait të saj

Një histori e rrallë është publikuar nga Dailymail, ku 33-vjeçarja Amanda Patterson ka sjellë në jetë fëmijën e vëllait të saj. Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë incest, por ajo ka qenë nënë mbartëse (surrogate). Amanda ka qenë bashkë me nusen e vëllait Rachel kur kanë mësuar se ajo është me kancer dhe nuk mund të lindte fëmijë. Doktori që i ka dhënë lajmin gjithashtu i ka sugjeruar që Amanda të ishte personi që do sillte në jetë fëmijë që tashmë Rachel ishte shtatzënë me të. Amanda pas bisedës që ka pasur me bashkëshortin, ka bindur kumatën dhe të vëllain se ajo do ishte personi ideal për të sjellë në jetë mbesën e saj. 33-vjeçarja është shprehur se lidhja me

Adayn është shumë e veçantë por jo si nënë e bijë edhe është ajo që e ka sjellë në jetë.



1055 - Teodora kurorëzohet Perandreshë e Perandorisë së Bizantit.  
1158 - Vladislavi II i Bohemisë shpallet mbret.  
1642 - Isak Njutni zgjidhet anëtar i Shoqërisë mbretërore.  
1758 - Trupat ruse okupojnë Königsberg, Prusinë lindore.  
1787 - Titania dhe Oberon, hënat e Uranit, zbulohen nga William Herschel.  
1803 - Monroe dhe Livingston lundrojnë për në Paris për të blerë Nju Orleansin.  
1919 - Romania përvetëson Transilvaninë.  
1942 - Japonia merr Kuala Lumpur.  
1946 - Enver Hoxha shpall veten diktator të Republikës Popullore të Shqipërisë.  
1960 - Çad shpall pavarësinë nga Franca.  
1998 - Sidi-Hamed masakra në Algjeri, vriten mbi 100 persona.

KALENDARI HISTORIK 11 JANAR

Për të gjithë ju që së fundmi jeni qortuar për gjuhën që përdorni - ka një mënyrë se si mund të mbroheni: Po tregoheshit të sinqertë, shkruan The Independent. Njerëzit që shajnë apo mallkojnë mund të jenë më të besueshëm, sipas hulumtuesve. Në studimin e publikuar nga ekipi i Gilad Feldman në Universitetin e Holandës u analizua sharja në shoqëri. Së pari, ekipi studioi 276 persona për të parë se pse ata mallkojnë. Ata pyetën këta persona për listën e preferuar të fjalëve fyese. Gjithashtu, hulumtuesit ju thanë që të shënojnë emocionet që ju ngjallen kur të përdorin ato fjalë - nervozë, zemërim apo frikë. Gjithashtu, pjesëtarët e tekstit plotësuan edhe një tekst psikologjik për të matur sinqeritetin e tyre që tregoi se sa ishte e mundshme që ata po gënjenin.



A E DINI SE...

## BURRI I TURPËRUAR

Burri i ankohet gruas sapo hyn në shtëpi:  
- U turpërova keq fare sot grua!  
-Pse, çfarë të ndodhi?, pyet gruaja  
- Me futi njëri dorën sot në xhep në autobus dhe nuk me gjeti kokërr denari!



Gjenialitet do të thotë të kesh aftësinë për të thënë një gjë mjaft të thellë në mënyrë të thjeshtë.  
**(Charles Bukowski)**

THËNIA E DITËS